

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7868 E martë 30 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Në tregun tonë shumë të pasur mediatic, në debatet parlamentare dhe qytetare, sidomos nga goja e të majtëve dhe të "papartishmëve", dëgjohet rëndom ...

Vijon në faqen 20

Nga XHEVAT MUSTAFA

A janë në të vërtetë 100% njësoj të dyja palët?



Opinion *i* **Ditës**

Nga ANDI BUSHATI

Rama doli kokulur nga Merkel

Anxhela Merkelit i ka ndodhur e njëjta gjë me ata që janë gënjer gjatë nga Rama: refuzimi për ta kredituar sërish. Ky mund të ishte konkluzioni i takimit të shkurtër; të ...



Fokusi, tek integrimi dhe reforma në drejtësi

Rama takon Merkel në Berlin, vendimi për negociatat do merret në shtator


Cakaj: Kancelarja e mbështeti Shqipërinë. Mogerini vjen në Tiranë për krizën politike

Kancelarja gjermane, Angela Merkel, ka pritur dje në një takim të veçantë kryeministrin Edi Rama. Takimi u mbajt në kuadër të Samitit të Berlinit, ndërsa çështjet e diskutimit kishin të bënin me ecurinë e reformës në drejtësi në Shqipëri, procesin e integritetit si dhe çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimet rajonale dhe sidomos mbi dialogun Kosovë-Serbi ...

Në faqen 3

TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, 7 DOKUMENTE DOREZOHEN NE ATP EMRAT, 800 PRONARET QE PERFITOJNE KOMPENSIMIN

Familjet që marrin paratë në Tiranë dhe në rrethe. Dokumentet që duhen, pronarët duhet të plotësojnë formularin dhe të dorëzojnë dëshminë e trashëgimisë



(Në foto) Zonë informale. Formulari për kompensimin e tokës

DIPLOMACI

Samiti i Berlinit, Merkel dhe Macron: Të bien tensionet mes Serbisë e Kosovës

Në faqen 13

SEANCA NE GJYQ

Vrasja e Bilalëve në Shkodër, dëshmitë e të arrestuarve: S'kemi lidhje me ngjarjen

Në faqen 6

KREU I PD

Basha: Betejë për jetë a vdekje, në zgjedhje pa Edi Ramën kryeministër

Në faqen 5

KREU I GRUPIT TE PS

Ballaj: Takimi mes Ramës e Bashës? Dialog vetëm në komisionin e reformës

Në faqen 2

PERPLASJA ME ARME



Vrasjet në Laç, në kërkim dy vëllezërit, policia: Si ndodhi dinamika e krimit

Në faqen 7

Tiranë/ Këshilli bashkiak: Numri i praktikantëve që do nisin punë në bashki

Kompensimi ushqimor për fëmijët në nevojë

Projektvendimi: Nivelet e pagave të punonjësve të njësisve administrative

NGA VOLTIZA DURO

Në 3 maj të këtij viti pritet të zhvillohet mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot të gjitha projektvendimet që priten të miratohen këtë të premte. Përkatesisht një rëndësi



e veçantë pritet t'i jepet kompensimit ushqimor për fëmijët e familjeve në nevojë në shkollat ku po implementohet projekti pilot "Bëjmë detyrat e shtëpisë". Sot publikohet edhe tabela përmbledhëse me emrat e përfituesve nga ...

Në faqen 14-15

SAMITI NEGOCIATAT

Nmuri 2 i socialistëve ka përjashtuar mundësinë e negociatave për zgjedhjen e krizës

Socialistët kanë hedhur shpesh mundësinë e mbajtjes së një tryeze negociatash për zgjedhjen e krizës politike. Duke iu përgjigjur thirrjes së aleatëve të demokratëve për mbajtjen e një tryeze negociatash për zgjedhjen e krizës me praninë edhe të kreut të PS-së, Edi Rama dhe atij të PD-së, Lulzim Basha, kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla është shprehur dje se e vetmja tryezë ku mund të diskutohet për garantitë e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme është ajo e reformës zgjedhore. Nga Pogradeci ku prezantoi kandidatin e socialistëve për kryetar bashkie, ai theksoi se PS është e gatshme të dialogojë me opozitën, por vetëm në kuadrin e komisionit të posaçëm të reformës zgjedhore, duke theksuar se aty mund të vendosen garantitë e nevojshme për një proces zgjedhor të ndershëm. "Ne kemi qenë gjithmonë të gatshëm për të dialoguar në Kuvendin e Shqipërisë. Përmes një procesi dialogu rikthyem në mbarrëvajtje komisionin e reformës zgjedhore dhe që është një instrument i rëndësishëm për të dialoguar lidhur me të gjitha domosdoshmëritë dhe nevojat që ka adresimi i paketës së ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, që lidhen me infrastrukturën e procesit zgjedhor dhe kemi hapur mundësitë e hulumtimit për të studiuar ndryshimin e sistemit zgjedhor", - theksoi më tej Balla. Në këtë mënyrë, duket se socialistët nuk janë të gatshëm të negociojnë asgjë tjetër veç ndryshimeve zgjedhore, duke përjashtuar kështu edhe mundësinë e uljes në një tryezë negociatash, të thirrur nga Presidenti i Republikës. Në vazhdimësi socialistët kanë theksuar se janë të gatshëm të dialogojnë, por jo të negociojnë për fatin e mandatis të qeverisë dhe të vet kryeministrit Rama. Në kuadrin të këtij qëndrimi, socialistët nuk janë të gatshëm tashmë të negociojnë as datën e zgjedhjeve vendore, të cilat sipas tyre do të mbahen në 30 qershor. "Duhet të jetë shumë e qartë për këdo që data e zgjedhjeve nuk caktohet nga partitë politike, por caktohet nga Kuvendi, nga Kodi Zgjedhor dhe data e zgjedhjeve në 30 qershor është një datë e fiksuar tashmë dhe në asnjë rast ajo nuk mund të ndryshojë", - u shpreh Balla në përfundim të një takimi me strukturat e Partisë Socialiste në Pogradec. Nga ana

Takim Rama-Basha? Balla: Dialog vetëm në komisionin e reformës

"Nuk janë budallenj që të bëjnë burg për hallet e Lulit"



Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla

PS prezanton Ilir Xhakollin si kandidat për Bashkinë e Pogradecit

Ilir Xhakolli është një nga deputetët socialist, që do të lërë mandatin e përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Shqipërisë, për të garuar për zgjedhjet për kryetar bashkie. Ai është përzgjedhur nga Partia Socialiste si kandidat për kryetar të Bashkisë së Pogradecit, e cila deri më tani drejtohet nga demokratët. Xhakolli është prezantuar dje në një takim të zgjeruar të socialistëve të Pogradecit, ku i pranishëm ishte sekretari i përgjithshëm i PS-së, Taulant Balla dhe në prani edhe të deputetit të zonës, Eduard Shalsi si dhe të përgjegjësit politik të zonës, Niko Peleshi. Lajmin e ka bërë të ditur fillimisht Eduard Shalsi, i cili nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale tregoi se Ilir Xhakolli do t'ua kthejë Bashkinë e Po-



gradecit socialistëve. "Me Ilir Xhakollin do të fitojmë Bashkinë e Pogradecit për të vijuar rrugën e reformave dhe rruformimin e qytetit", - tha Shalsi. Nderkohë që Partia Socialiste pritet që gjatë kësaj jave të mblledhë sërish kryesinë për të diskutuar dhe miratuar kandidaturën për kryetar bashkie në ato qytete ku ky proces nuk ka përfunduar ende, ndërsa në javën e dytë

të majit do të mblledhë edhe Asambleen Kombëtare për të bërë një konfirmim formal të tyre. Në fakt, Partia Socialiste ka nisur ndërkohë një proces takimesh nëpër bashki të ndryshme, ku po bën një prezantim të disa prej kandidatëve. Kujtojmë se javën e shkuar PS konfirmoi Valdrin Pjetrin si kandidat për Shkodrën dhe Gledian Llatjan si kandidat për Elbasanin.

të gjithë spektrit politik. Sipas Ballës, në çdo rast që do tentohet të prishen zgjedhjet, do të veprojë ligji. "Në 30 qershor do të zhvillohen zgjedhjet, janë 42 parti të regjistruara, askush nuk mund të pengojë të pjesëmarrjen në zgjedhje, kush tenton të pengojë zgjedhjet të marin pjesë në procesin zgjedhor,

DIALOGU

"Ne kemi qenë gjithmonë të gatshëm për të dialoguar në Kuvendin e Shqipërisë. Përmes një procesi dialogu rikthyem në mbarrëvajtje komisionin e reformës zgjedhore dhe që është një instrument i rëndësishëm për të dialoguar lidhur me të gjitha domosdoshmëritë dhe nevojat që ka adresimi i paketës së ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, që lidhen me infrastrukturën e procesit zgjedhor dhe kemi hapur mundësitë e hulumtimit për të studiuar ndryshimin e sistemit zgjedhor".



Zgjedhjet, PS shpall sot koalicionin elektorale, nënshkruhet marrëveshje

Në dërsia opozita nënshkroi javën e shkuar marrëveshjen për të mos u bërë pjesë e zgjedhjeve lokale me Ramën kryeministër; të majtët nënshkruajnë sot marrëveshjen për krijimin e koalicionit zgjedhor. Kështu, sot në mesditë PS do të nënshkruajnë marrëveshjen parazgjedhore dhe një platformë bashkëpunimi me të aleatët e vet të vegjël, me të cilët do të shkojë në zgjedhjet e 30 qershorit. Burime nga PS kanë bërë të ditur se janë mbi 22 parti që kanë rënë dakord që të nënshkruajnë këto dy dokumente, të cilat konfirmojnë gjithashtu vullnetin politik dhe ligjor për të qenë pjesë e koalicionit zgjedhor. Të njëjtat burime kanë bërë të ditur se dokumentet e hartuara nga Petro Koçi si përfaqësues i PS dhe Gjergji Koja si përfaqësues i partive të vogla është dakordësuar me shumicën e aleatëve, ndërsa sot do të hidhet edhe firma, para se marrëveshja e krijimit të koalicionit të paraqitet në KQZ për regjistrim. Mësohet se formula e bashkëpunimit përcakton se PS në bazë të peshës specifike që ka secila forcë në elektorat, dhe kjo bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të mëparshme, do të bëjë edhe përfshirjen e emrave të veçantë në vendet e sigurta në listën e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë. Burime të tjera nga kampi i majtë bëjnë të ditur se pjesë e këtij koalicioni janë kryesisht forca, që edhe në zgjedhjet vendore të 2015-ës dolën në një koalicion me Partinë Socialiste, me përjashtime të vogla.

Kodi Penal është i ashpër. Kush tenton të dëmtojë procesin zgjedhor, të dëmtojë infrastrukturën zgjedhore, kutinë e votimit dënimit e Kodit Penal janë shumë të ashpër. Nuk besoj që ka ende në Shqipëri budallenj që të bëjnë burg për hallet e Lulit, Saliut dhe të Monës. Dua t'ju them shumë qartë që kush-



Kancelarja gjermane, Angela Merkel, gjatë takimit të djeshëm me kryeministrit Edi Rama

do PS-së nuk mund t'i vendosë askush, sepse nuk mund t'u vendosen kushte shqiptarëve. Kushte që pengojnë implementimin e reformës në drejtësi, kushte të cilat tentojnë të ndërpresin mandatin legjitim. Kuvendin apo të qeverisë nuk merren në konsideratë", - u shpreh Balla.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rretheve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokhina 0682074397, Shpërndarja: Elvira Llika Cel 0682074416, Marketingu: Cel: 0688087823 - email: marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtori dhe Uzinës së Autotrafikëve, Tiranë - Tel: (04) 2359-104 Tel&Fax: (04) 2359-116 Marketingu: Tel: (04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPIUR në "Klasik" Shqip



Ministri i Jashtëm bëri të ditur se kancelarja mbështeti hapjen e negociatave me BE-në

Rama takon Merkelin: Reforma në drejtësi dhe integrimi, në fokus

'DW': Vendimi për negociatat merret në shtator

Kancelarja gjermane, Angela Merkel, ka pritur dje në një takim të veçantë kryeministrin Edi Rama. Takimi u mbajt në kuadër të Samiit të Berlinit, ndërsa çështjet e diskutimit kishin të bënin me ecurinë e reformës në drejtësi në Shqipëri, procesin e integrimit si dhe çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimet rajonale dhe sidomos mbi dialogun Kosovë-Serbi. Vetë kryeministri Edi Rama publikoi në faqen e tij në "Facebook" një video të momentit të pritjes nga kancelarja jashtë ndërtësës, teksa të dy shtrënguan duart për kamerat dhe aparatet e fotografike. Gjatë pritjes u vu re edhe prania e dy ministrave shqiptarë, Gent Cakaj dhe Elisa Spiroglu.



"DEUTSCHE WELLE"
"Merkel megjithatë nuk mund të marrë asnjë vendim pa miratimin e Bundestagut. Siç mësoi 'DW' nga qarqet politike pranë CDU-së, afati kohor që nga publikimi i raportit të progresit të BE-së më 29 maj deri në samitin e BE-së në qershor nuk mjafton për të marrë një vendim për çeljen e negociatave. Burime nga CDU/CSU i thanë 'DW' se vendimi i tyre do të shtyhet në shtator", - thuhet në artikullin e 'DW'.

SHKURTE

Kriza politike, Mongerini viziton Tiranën në 8-9 maj

Në kulmin e krizës politike në Shqipëri, shefja e diplomacisë europiane, Federica Mogherini pritet të vizitojë javën tjetër Tiranën. Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Europian për Punët e Jashtëm dhe Politikën e Sigurisë pritet të jetë në Tiranë në datat 8-9 maj. Ajo do marrë pjesë në aktivitetet, në kuadër të Ditës së Europës dhe kryeministrin Rama dhe përfaqësues të opozitës. Mogherini është ftuar dhe nga presidenti Meta të marrë pjesë në punimet e samitit të Brdo-Brijun, ku mblidhen të gjithë presidentët e Ballkanit, për të diskutuar për projektet e përbashkëta dhe ndihma që duan nga BE. Vizita e Mogherinit përkon me ditën e Europës dhe do të zhvillohet një muaj përpara se Këshilli i Europës të marrë një vendim për hapjen e negociatave të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Natyrisht që vizita e saj vjen në një moment të vështirë për Shqipërinë, pasi vendi ndodhet në një krizë politike. Nuk dihet nëse kriza do jetë zgjidhur deri në vizitën e Mogherinit në Tiranë apo jo, por nëse palët në vend ende nuk do kenë gjetur një zgjidhje, atëherë kjo vizitë mund të shërbejë edhe si një mundësi e mirë për të diskutuar me politikën shqiptare gjatjen e një kompromisi. Vetëm dy ditë pas vizitës së Mengherinit në Tiranë, opozita ka paralajmëruar protestën e katërt kombëtare.

Berisha: Marrëveshja Kosovë-Serbi, patatja e nxehtë e samimit

Isht kryeministri Sali Berisha shprehë se Samiti i Berlinit është shumë i rëndësishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në veçanti për Shqipërinë dhe Kosovën. Ai pohon se patatja e nxehtë e Samitit është marrëveshja Kosovë-Serbi, ndërsa shton se ajo ka në mes edhe dy pengesa kryesore. "Patatja e nxehtë e samitit është marrëveshja Kosovë-Serbi. Lidhur me këtë marrëveshje dy janë pengesat madhore të saj. Së pari, marrëveshja e fshehtë për copëtimin e Kosovës dhe krijimin e Serbisë së madhe e arritur nga argatët e Beogradit në Tiranë dhe Prishtinë me patronin e tyre, presidentin serbomadh Vuçić. Së dyti, shqiptarët e Kosovës përfaqësohen në samit defacto nga dy delegacione. Delegacioni i argatit të Beogradit, i cili si peng i këtij të fundit, projektin e Serbisë së Madhe e paraqet si projekt të Prishtinës. Në krah të tij qëndron i palëkundur Zografi bis i Tiranës. Delegacioni i kreut të ekzekutivit të Kosovës që kundërshton projektin e Serbisë së Madhe dhe që për të paralajmëruar marrëveshjen e fshehtë të krijimit të saj në kurritz të territorit të Kosovës ka vendosur takësin antiargat duke krijuar një problem të vërtetë me komunitetin ndërkombëtar", - shprehë z.Basha.

Hahn: KE do të rekomandojë hapjen e negociatave për Shqipërinë

Eurokomisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn, është shprehur i sigurt se Komisioni Europian do të rekomandojë hapjen e negociatave për Shqipërinë. Gjatë një interviste për "Handelsblatt", Hahn shpreh optimist se KE-ja do të rekomandojë çeljen e negociatave si për Shqipërinë, ashtu edhe për Maqedoninë e Veriut. Sipas Hahn, hapja e negociatave nuk është vetëm në interes të vendeve të rajonit, por edhe të vetë Unionit. Hahn beson se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut e meriton hapjen e negociatave, e cila u shty vitin e kaluar për në qershor 2019. "Nuk bëhet fjalë vetëm për popu-



it e Europës Juglindore, por edhe për interesat tona. Ose eksportojmë stabilitet, ose importojmë destabilitet. Vendet ballkanike janë fqinjët

tanë dhe nuk mund të rrimë indiferentë për situatën e tyre politike dhe ekonomike", - u shpreh Hahn për të përditshmen gjermane "Handelsblatt". Sipas tij, vlerësimi për këtë rekomandim do të bëhet mbi bazën e plotësimit të kriterieve nga secili shtet. Por pavarësisht kësaj, i rëndësishëm është qëndrimi që do mbajnë vendet anëtare të BE-së. Sipas medias tjetër gjermane "Deutsche Welle", të paktën sa i përket Gjermanisë, një "po" nga parlamenti gjerman është vështirë të vijë para shtatorit. Për këtë, ajo iu referua burimeve nga grupimi politik që mbështet qeverinë e Merkelit.

GENT CAKAJ

Nërkohë që fill pas këtij takimi ka reaguar edhe ministri në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtëm, Gent Cakaj, gjithashtu i pranishëm në këtë takim. Por, ndryshe nga njoftimi i Kryeministrit, Cakaj në postimin e vet ka qenë më optimist mbi rezultatet e këtij takimi. Kjo, pasi ai ka folur për një mbështetje që ka dhënë Gjermania për hapjen e negociatave, pasi ka analizuar prioritetet që kishte për të plotësuar vendi ynë. "Progresi i madh i Shqipërisë në 5 prioritetet kyçe, me theks të

veçantë në reformën në drejtësi merr vlerësimin më të lartë nga Gjermania. Shqipëria do të vazhdojë të luajë rolin e saj të pazëvendësueshëm në stabilitetin rajonal dhe afirmimin e vlerave evropiane në Ballkanin Perëndimor! Shumë mirënjohës për përkushtimin e kancelares Merkel ndaj Shqipërisë!", - shkroi Cakaj.

NEGOCIATAT

Por, pavarësisht këtij optimizmi, "Deutsche Welle" bëri të ditur dje se shpresat që vendimi për negociatat të merret në qershor janë të pakta. Për këtë 'DW' i refer-

ohet burimeve pranë CDU-së, të cilat i kanë bërë të ditur se ky vendim do të shtyhet për në shtator. "Merkel megjithatë nuk mund të marrë asnjë vendim pa miratimin e Bundestagut. Siç mësoi 'DW' nga qarqet politike pranë CDU-së, afati kohor që nga publikimi i raportit të progresit të BE-së, më 29 maj deri në samitin e BE-së në qershor nuk mjafton për të marrë një vendim për çeljen e negociatave. Burime nga CDU/CSU i thanë 'DW' se vendimi i tyre do të shtyhet për në shtator", - thuhet në artikullin e 'DW'.

EPSEA SHOERIA PERMBARUES PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANADIT PËR:

"Ullishte (Trual)" me sip. 14.700 m², Nr. Pasurie 56/3, Vol.29, Fq.15, ZK 8605, i ndodhur në Vloca 5, Vlore dhe "Objekt karabina 4 Kat + 1 Kat bodrum" me sip. 1.262 m², Nr. Pasurie 56/3-ND, ZK 8605, i ndodhur në L.11 Janari, Vlore në pronësi të Shkollës Internacionale shpk. Keto pasuri janë hipotekuar në favor të Banka ProCredit sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 3.135.524 Euro. Ankandi zhvillohet datë 09.05.2019 ora 16.00 në adresën Rt.1, Cemali, Pall. "Fratri", K.6, Tirane.
Per cdo informacion mund te kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne web www.epsa.al.

PLATFORMA OPOZITA

"Qeveri kujdestare 6 muaj para zgjedhjeve për 15 vite me radhë", ku ndahen aleatët me PD-në

Valentina Madani

Kriza, aleatët thirrje Bashës: Dialogo me Ramën si kreu i PS-së

Partitë e vogla sot takojnë Metën: Të negociojë në tryezë



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dhe me përfaqësuesit e institutit Republikan Amerikan për Evropën

Alleatët e Lulzim Bashës, pjesë e grupimit të qendrës së djathtë, i kërkojnë Presidentit Ilir Meta të ulë në tryezë dialogu të gjitha palët politike për zgjidhjen e krizës. Përmes një platforme prej 12 pikash, kërret e PR, LZHK, PBDNJ, PAA, PDK-së shprehen kërkojnë një marrëveshje kushtetuese, duke përjashtuar një pakt të ngjashëm si ai i 18 majit të 2017-ës. Në këtë mënyrë, partitë e vogla po tentojnë të ulin sërish përballë njëri-tjetrit Edi Ramën dhe Lulzim Bashën për t'i dhënë vendit një zgjidhje jo vetëm politike, por edhe kushtetuese përmes një tryeze të thirrur nga Presidenti Meta. Në funksion të kësaj zgjidhjeje do jetë edhe takimi i sotëm i partive të qendrës së djathtë me kreu e shtetit, Ilir Meta.

KËRKESAT

Kreu i republikanëve, Fatmir Mediu, shprehu dje bindjen se pavarësisht klimës së vështirë politike, ulja me Edi Ramën si kryetar i PS-së në tryezë nuk duhet të paragojëkohet. "Nesër (sot) në takimin që do kemi me Presidentin e Republikës ne do t'i kërkojmë presidentit dhe do të angazhohemi mbështetjeje e tij dhe faktorëve të tjerë ndërkombëtare dhe politikë shqiptarë për të zgjidhur këtë situatë që është e paprecedentë, siç u shpjegua edhe në deklaratë. Ne kërkojmë që presidenti, bazuar në autoritetin kushtetues, të garantojë unitetin e popullit nëpërmjet një procesi zgjedhor të lirë. Kjo është kërkesa që ka opozita. Besoj që procesi jo vetëm që nuk është i lirë dhe i ndershëm, por për më tepër po e çon vendin në një konflikt, duke cenuar unitetin e popullit", deklaroi Mediu. Një ndër kërkesat e aleatëve është edhe shtyrja e zgjedhjeve lokale dhe krijimi i një qeverie transitorie, pikë që i bashkon me Partinë Demokratike, me të cilën firmosën një marrëveshje pak ditë më parë. Vangjel Dule, kryetar i PBDNJ-së u shpreh: "Nuk është antikushtetuese shtyrja e zgjedhjeve, kemi rastin e Kavajës në 2017-ën. Nuk janë kushtet aktuale për zgjidhje, veç asaj të një konsensusi shumë të gjerë". Kurse kreu i PAA-së, Agron Duka, bëri të qartë: "Hymjë në zgjedhje me qeveri transitorie, po e pranoi Rama këtë të parën, të jesh e sigurt ti që ulet Basha me Ramën, padyshim nëse pranon këtë të parën. Në zgjedhjet e ardhshme duhet të hymjë të gjithë bashkë. Duhet qeveri transitorie".

NDASITË

Ajo që i ndan me Lulzim Bashën e që ia kujtuuan sërish në tryezë është ndryshimi i sistemit zgjedhor. Për këtë, Dashamir Shehi, krye-



Aleatët e PD-së

DEKLARATAT

DASHAMIR SHEHI "Ne kërkojmë ndryshimin e Kodit Zgjedhor. A ka të PD që mendojnë si ne ose ndryshe? Plot. PD në këtë pikë nuk ka dhënë një qëndrim të saj përfundimtar. Me PD, kjo është një nga pikat që kemi debat", tha Shehi.

NARD NDOKA "Edhe z.Rama mund të ulet në tryezë institucionale si kryetar i PS. Kjo është krizë e thellë, që përgjegjësia është e kryeministrit, pavarësisht se ai është shkaktari, theksoi kreu i PDK-së.

AGRON DUKA "Hymjë në zgjedhje me qeveri transitorie, po e pranoi Rama këtë të parën, të jeni të sigurt që ulet Basha me Ramën, padyshim nëse pranon këtë të parën. Duhet qeveri transitorie", u shpreh kreu i PAA.

etar i LZHK-së u shpreh: "Ne kërkojmë ta ndryshojmë. Partia Demokratike nuk ka dhënë në këtë pikë një qëndrim dhe për këtë arsye ne kemi sot një debat me PD. Këtë ligj që kemi sot s'e duam". Teksa Lulzim Basha e ka kusht të pënegociueshëm uljen në tryezë me kryeministrit, grupi i qendrës së djathtë nuk përjashton mundësinë e përfshirjes së Ramës si kryetar i PS-së, pa dhënë më parë dorëheqjen nga kryetar i qeverisë. "Nuk është një kusht, edhe zoti Rama mund të ulet në tryezë institucionale si kryetar i PS. Kjo është krizë e thellë, që përgjegjësia është e kryeministrit, pavarësisht se ai është shkaktari. Lulzim Basha është shprehur që nuk është kundër dialogut, në çdo tryezë që ne jemi të barabartë si forca politike nuk ka asnjë pengesë, dhe besoj se ky do të jetë qëndrimi i opozitës së bashkuar", tha Nard Ndoka, kreu i PDK-së.

PLATFORMA

Pesë aleatët e Lulzim Bashës dolën dje me një platformë me 12 pika, që sipas tyre jo vetëm zgjidh krizën politike, por forcon institucionet në të ardhmen. Platforma ndërhy në Kushtetutë, ndërka kërkon përcaktimin e një dispozite transitorie për krijimin e një qeverie kujdestare 6 muaj përpara zgjedhjeve, kjo për 15 vitet e ardhshme. Më tej, ata kërkojnë president nga populli, kufizim të mandatit të kryeministrit dhe deputetëve për të cilët duhet të jetë i

Fatmir Mediu

"Ne kemi folur të gjithë së bashku dhe po i drejtohem presidentit të thërrasë tryezën. Përfaqësuesit e politikës duhet të ulen për të gjetur një zgjidhje", tha kreu i PR-së.

Vangjel Dule

"Nuk është antikushtetuese shtyrja e zgjedhjeve, kemi rastin e Kavajës në 2017-ën. Nuk janë kushtet aktuale për zgjidhje, veç asaj të një konsensusi shumë të gjerë", - u shpreh kreu i PBDNJ-së.

NGA KUFIZIMI I MANDATEVE TE NDRYSHIMI I SISTEMIT, TË GJITHA PROPOZIMET E ALEATËVE TË BASHËS

- Thirrja e një tryeze politike nga Presidenti i Republikës, e përfaqësuesve të opozitës dhe mazhorancës.
- Bazuar në Nenin 86/1, presidenti është garant i unitetit të popullit. Ky unitet garantohej nga respektimi i të drejtave dhe lirive të qytetarëve, në respekt të Kushtetutës.
- Neni 1 i Kushtetutës sanksionon se "qeverisja bazohet në një sistem zgjedhës të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike".
- Mungesa e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme po shkatërron parimin themelor e kushtetues të pluralizmit.
- Kjo tryezë të vlerësojë kushtet dhe kërkesat e OSBE/ODHIR për të shmangur shitblerjen e votës, intimidimin e votuesve dhe përdorimin e administratës shtetërore.
- Kontrolli mb territorin dhe procedimi i grupeve kriminale, të cilat janë evidentuar në shitblerjen e votës.
- Procedimin penal nga ana e prokurorisë të dosjeve të bëra publike nga media, për manipulimin e zgjedhjeve.
- Vlerësimin e skadimit të afatit të identitetit dhe pajisjen e qytetarëve me karta.
- Vlerësimin e përjashtimit nga lista të mbi 270,000 votuesve.
- Përcaktimi i një date për zgjedhjet lokale dhe parlamentare, me një qeverisje transitorie (qeverisje kujdestare) me dakordësi politike.
- Data e zgjedhjeve të përcaktohet në përputhje me detyrimet dhe implementimin nga qeverisja transitorie, e kushteve për zgjedhjet të lira dhe të ndershme dhe shikëputjes së strukturave të shtetit nga krimi i organizuar.
- Reformë zgjedhërore, e cila ndalon financimin e paligjshëm, dënon jo vetëm njëriçetë e angazhuar në blerje dhe manipulim votash, por edhe subjektet politike që marrin pjesë në manipulimin e zgjedhjeve.
- Kthimi i parlamentit në një parlament përfaqësues dhe kushtetues, nëpërmjet ndryshimit të sistemit zgjedhor, nëpërmjet një sistemi zgjedhor dhe votimi me lista të hapura, ku qytetarët të zgjedhin jo vetëm partitë politike, por edhe deputetët që do t'i përfaqësojë në parlament, si dhe një shpërndarje të mandateve në përputhje me parimin e barazisë së votës.
- Përcaktimi me një dispozitë transitorie kushtetuese për një periudhë 15-vjeçare, i krijimit të një qeverie kujdestare 6 muaj përpara zgjedhjeve, duke përcaktuar me ligj formën, kriteret e përfaqësimit dhe detyrat e saj.
- Vlerësimi i kuadrimit kushtetues të vendit, me një grup të posaçëm ekspertësh të së Drejtës Kushtetuese, vendës dhe të huaj, për të mundësuar kthimin e Republikës Parlamentare dhe funksionimin e saj, bazuar në pavarësinë dhe balancimin në pushteteve.
- Bashkëpunimi për një vlerësim të drejtë të Reformës në Drejtësi, funksionimi urgjent i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, qoftë edhe me një amendim të përkohshëm, për t'i bërë ato funksionale, duke zhvilluar një proces për të garantuar integritetin, profesionalizimin dhe pavarësinë e tyre.
- Kufizimi i mandatit të kryeministrit dhe deputetëve.
- Të bëhet testi i drogës për presidentin, kryeministrit dhe deputetët.
- Zgjedhja e Presidentit të Republikës drejtpërdrejt nga populli dhe jo nga mazhoranca apo pazare politike. Zgjerimi i kompetencave të tij në fushën e sigurisë dhe drejtësisë.
- Krijimi i një sistemi parlamentar me dy dhoma, senat dhe dhomë e përfaqësuesve. Senati të ushtrrojë një pjesë të detyrave dhe kompetencave të Gjykatës Kushtetuese dhe një pjesë tjetër të kompetencave të Gjykatës Kushtetuese t'i kalojë Gjykatës së Lartë.
- Rishikimi i reformës administrative, për ta çuar pushtetin lokal afër dhe jo në shërbim të njerëzve dhe jo vetëm në qendrat e mëdha urbane, me qëllim kthimin politik të territorit.



Zgjedhjet e lira, PD bën gati dokumentin për detyrat e qeverisë transitore

Basha: Betejë për jetë a vdekje, në zgjedhje pa Ramën kryeministër

Takimi sot në Presidencë, kreu i PD takon aleatët

Valentina Madani

Partia Demokratike ka përfunduar një dokument të detajuar sa u përket detyrave të qeverisë transitore në raport me zgjedhjet e lira. Edhe aleatët nga e tyre po bëjnë çdo përpjekje që con drejt zgjidhjes së ngërcit politik. Një ditë para takimit me Presidentin e Republikës Ilir Meta, kryetari i PD-së Lulzim Basha thirrri pasditën e djeshme në zyrrë aleatët. Partinë e vogla po tentojnë të ulin sërish përballë njëri-tjetrit Edi Ramën dhe Lulzim Bashën për t'i dhënë vendit një zgjidhje jo vetëm politike, por edhe kushtetuese, përmes një tryeze të thirrur nga Presidenti Meta. Lulzim Basha është shprehur publikisht se nuk ulet me Edi Ramën në dialog, por aleatët besojnë se edhe kryedemokracia do të pranohet të bëhet pjesë e zgjidhjes, pasi në tryezë Edi Rama do të ulet si kryetar i Partisë Socialiste. Këtë qëllim i shërbeu dhe edhe tryeza e 5 aleatëve të PD-së. Menjëherë, pasi aleatët e Lulzim Bashës shpалosën platformën për zgjidhjen e krizës politike, kreu demokrat bëri të qartë se qëndrimet e partive opozitare janë në përputhje të plotë me marrëveshjen e firmosur pak ditë më parë. "Nuk ka asnjë mospërputhje mes qëndrimeve të PD-së dhe të gjithë koalicionit tonë. PD ka përfunduar javën e kaluar një dokument të detajuar sa u përket detyrave të qeverisë transitore në raport me zgjedhjet e lira dhe të ndershme dhe do ta paraqesë në ditët e ardhshme në mënyrë publike. E kemi diskutuar edhe me aleatët tanë dhe një pjesë e mirë e pikave që aleatët kanë shpалosur sot janë edhe pikat e programit tonë, ka përputhje totale. Koalicioni opozitar po vepron me bashkëpunim, mirëkuptim dhe sinerji të plotë për të ecur përpara", u shpreh kreu i PD-së.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

FIRMËTARJA
Gruaja e Agron Xhafaj është një nga firmëtarët e krijimit të Partisë së Patozit "Bindja Demokratike". Në dokumentin e depozituar në gjykatë, një nga firmëtarët është Etleva Përparim Xhafaj, që rezultoi të jetë bashkëshortja e Geron Xhafajit, vëllai të ish-ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj.

BASHKËPUNIMI

"Nuk ka asnjë mospërputhje mes qëndrimeve të PD-së dhe të gjithë koalicionit tonë. Një pjesë e mirë e pikave që aleatët kanë shpалosur sot janë edhe pikat e programit tonë, ka përputhje totale. Koalicioni opozitar po vepron me bashkëpunim, mirëkuptim dhe sinerji të plotë për të ecur përpara", u shpreh kreu i PD-së.



"Qeveri transitore", Vokshi: Zgjedhje pa opozitën nuk do të ketë

Ish-deputetja demokrate, Albana Vokshi, u shpreh e bindur se nuk do të ketë zgjedhje pa opozitën në 30 qershor. Vokshi theksoi se fronti opozitar do të vijojë të insistojë në kërkesat e propozuara, me qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. "Një gjë është e sigurt, zgjedhje pa opozitën e vërtetë nuk do të ketë! Zgjedhje pa u krijuar të gjitha kushtet dhe standardet për vote të lirë e të ndershme, nuk do të ketë! Hapi i parë që kërkohet nga fronti opozitar është krijimi i një qeverie tranzicioni, që të miratojë reformën zgjedhore që do të krijojë kushte e standarde për zgjedhje të lira e të ndershme. Së dyti, të ndëshkohen të gjithë zyrtarët e lartë, nisur nga Edi Rama, Vangjush Dako, Damian Gjiku dhe çdo zyrtar tjetër që ka marrë pjesë në krimin elektoral të vjedhjes dhe blerjes së votave në zgjedhjet e fundit. E së treti, të inkurajojë një reformë në drejtësi jo të politizuar, që fillon nga funksionimi i Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë e kështu me radhë, për të dhënë drejtësinë që të gjithë shqiptarët e meritojnë", - u shpreh zj. Vokshi. Ajo i bëri deklaratat në Berat, ku zhvilloi një takim me gratë demokrate të këtij qyteti. Ajo u kërkoi atyre që t'i bashkohen protestës së opozitës në 11 maj, me qëllim rrëzimin e qeverisë.

DEKLARATAT

KANDIDATËT

Ndonëse z.Basha ka paralajmëruar bojkotin e zgjedhjeve nëse nuk plotësohen kushtet që garantojnë një garë të ndershme, PD synon që kandidatët në zgjedhjet e ardhshme do të dalin nga primaret. "PD pavarësisht prej sistemit zgjedhor që do të ketë Shqipëria, do t'i zgjedhë kandidatët e vet me një anëtar-një votë. Jemi sot në një betejë për jetë a vdekje për demokracinë", - tha z.Basha.




MONIKA KRYEMADHI

Kryetaria e LSI paralajmëroi dje se partia e saj së shpejti do të paraqesë një program të qartë për mbështetjen e fermerëve dhe blegtorëve. Kryemadhi apelon shqiptarët të konsumojnë produktin vendas. "50% e popullsisë jeton edhe punon në ferma, apo merret me blegtori. Ne duhet të jemi në krah këtyre njerëzve punëtorë dhe të palodhur, që shteti i Rilindjes i ka lënë si qytetarë të dorës së dytë", tha zj.Kryemadhi.



LSI, Gjoshja: Rama do të dorëzohet, do të ketë qeveri transitore

Ish-ministria e Integritimit, Kladja Gjoshja, e ftuar dje në "News 24" shprehu sigurinë e plotë se në qershor nuk do të ketë zgjedhje. Sipas Gjoshës, nëse kryeministri Edi Rama vendos të futet në zgjedhje, atëherë ky veprim do të ishte vetëvrasje për të edhe për Partinë Socialiste. "Do të jetë vetë presidenti, i cili do të veprojë sipas Kushtetutës. Kërkesa e aleatëve është e drejtë. Sot nuk mund të diskutohet për zgjedhjet lokale pa zgjidhur atë se çfarë është bërë në 2017-ën. Kushti është largimi i Ramës dhe krijimi i një qeverie transitore. Nëse ai do të shkojë në zgjedhjet monopartiake, do të ishte një vetëvrasje politike. Besoj se nuk mund të shkohet në zgjedhje pa u ulur e biseduar. Nuk do të shkohet në zgjedhje. Të jeni të bindur. Edhe vetë kryeministri do të dorëzohet, patjetër që vendi do të shkojë në krijimin e një qeverie transitorie. Nëse jo, do të jetë një vetëvrasje për Ramën dhe PS-në. Sot qytetarët e kanë kuptuar që pas 2017-ës, e shohin se asgjë nuk u rikthet atyre dhe familjeve të tyre", - deklaroi z.Gjoshja.



inale dhe kushti për këtë mbetet largimi i Edi Ramës nga qeveria dhe një qeveri transitore, që do të plotësojë kushtet për të cilat do të kemi shumë informacione në ditët në vijim", deklaroi kreu i PD-së. Ndonëse Lulzim Basha ka paralajmëruar bojkotin e zgjedhjeve nëse nuk plotësohen kushtet që garantojnë një garë të ndershme, Partia Demokratike synon që kandidatët në zgjedhjet e ardhshme do të dalin nga primaret. Një formë demokratizimi dhe modernizimi kjo e PD-së sipas Bashës, për të cilën po japin kontributin përfaqësues të Institutit Ndërkombëtar Republikan. "PD pavarësisht prej sistemit zgjedhor që do të ketë Shqipëria, do të zgjedhë kandidatët e vet me një anëtar-një votë. Jemi sot në një betejë për jetë a vdekje për demokracinë", u shpreh kreu i PD-së.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Zyra Permbareme Fier me përmbareus gjyqësor Arian CEPELE me adresë Lagja "29 Nentori" godina e Gjykatës Fier nga mbropa, njofton se më date 18.04.2019-02.05.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i 1-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr. 77/32 - ZK. 2890, me sipërfaqe 1124 m2 me adresë Patos,Fier, në pronësi Z.Haxhi & Gjeje Rrapaj me vlerë fillestare në ankand 4 960 000 (katërmilionenëntëqindëgjatëdhjetë mijë) LEK.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 697262655.

Ka marrë kredi për familjen, bashkëshortja apel për ndihmë ekonomike

"Flinte me armë nën jastëk", rrëfëhet gruaja: Si jam dhunuar për 13 vite

U martua me mblesëri, jetesa e vështirë e 31-vjeçares

Një 31-vjeçare, nënë e 4 fëmijëve ka rrëfyer dje në emisionin "Me Zemër të Hapur" dhunën e ushtruar prej vitesh nga ish-bashkëshorti i saj. Gruaja nga Mamurasi është martuar 13 vite më parë në një moshë shumë të re dhe martesë e saj gjithmonë ka qenë problematike. Njohja me bashkëshortin është bërë me mblesëri, ajo thotë se me të e ka njohur kunati. "U njoha në moshën 19-vjeçare me mblesëri, ishte vëllai i bashkëshortit, kunati im", - tregon 31-vjeçarja. Gruaja rrëfen se gjatë martesës, shpeshherë është konfliktuar me bashkëshortin, konflikte të cilat i kanë rrezikuar edhe jetën asaj. "Unë mblidhja lule në mal, ai flinte gjumë. Në darkë nuk vinte në shtëpi, lekët që fitoja, i shpenzonte për vete. Unë punoja, kam marrë edhe kredi, me ato të ardhura ndërtova tri dhoma. E braktisa atë banesë që e ndërtova me të ardhurat e mija, se jemi në një oborr, ndihem e përbuzur se e denoncova", - rrëfen ajo. 4 vite më parë 31-vjeçarja mori guximin dhe e denoncoi



bashkëshortin. Gjykata i dha nënës se 4 fëmijëve urdhër mbrojtjeje, ndërsa la në burg burrin duke e dënuar me 8 muaj. Por, gruaja pas daljes së bashkëshortit nga burgu vendosi të rikthehet me të. Situ-

ata e vështirë ekonomike, por edhe pamundësia për t'i rritur e vetme fëmijët bëri që gruaja të rikthehej. Nuk kaloi shumë kohë dhe ajo u përball sërish me dhunën. Bashkëshorti rifilloi konfliktet në familje, të cilat de-

gjeneronin gjithmonë në dhunë, kjo e detyroi sërish gruan ta denonconte dhe tre muaj më parë, ajo mori sërish urdhër mbrojtjeje, ndërsa bashkëshorti ndodhet pas hekurave. Ajo tregon se dhunës nuk i kanë

shpëtuar as fëmijët e saj, madje edhe më i vogli, vetëm tre vjeç. "Djali linte shkollën e vinte me mua, e detyronte ai për të mbledhur lule në mal. Si mund të punonte ai, vetëm 11 vjeç, e babai të flinte?! Më dhunonte në sy të fëmijëve të vegjël, vajza e vogël e kujton edhe sot. Ishte i dhunshëm edhe me fëmijët. Edhe më të voglin, tre vjeç e ka dhunuar. Dhunonte se nuk kishte lekë për të dalë dhe nevrkosej. Durova në fillim se nuk doja të prishja familjen. Duroja dhunën që fëmijët mos rriteshin pa baba", rrëfen gruaja, e cila tregon se ish-bashkëshorti i thoshte: "Po të duash rri si shërbëto, ose ik largohu, je e lirë". Ajo madje rrëfen se ish-burri i saj flinte me armë nën jastëk. "Herën e fundit më kërcënoi edhe me armë, e

perjetonin edhe fëmijët, e mbante poshtë jastëkut. Familja prej turpit më thoshte të duroja. Iu kam thënë disa herë që ka edhe armë. Por nga turpi duhet të duroja, në fshat ndryshon gjithçka, gruaja duhet t'i nënshtrohet burrit për gjithçka. Më thoshin se duhet të qëndroja, më thoshin 'duroje se burri të rreh', iu vinte turp që të ndahesha", - rrëfen ajo. Gruaja sot ka frikë për të ardhmen, ajo ka nisur procesin e divorcit, por ndihet e kërcënuar, pasi ka frikë të përballlet me bashkëshortin në momentet kur ai të dalë na burgu. 31-vjeçarja bën apel për ndihmë. Ajo thotë se me të ardhurat e saj e ka të pamundur të rrisë e vetme 4 fëmijët e saj, si edhe të paguajë kredinë e marrë gjatë martesës me bashkëshortin.



NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti Shitës:** Albpetrol Sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7.
- Data e zhvillimit të ankandit:** 03.05.2019, ora 11:00.
- Lloji i Procedurës të ankandit:** Procedure e hapur.
- Objekti i Shitjes:** Shitje nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Afati i evadimit:** 270 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Vlera fillestare:**

Ne kushtet FOB:

Çmimi minimal fillestar per njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent + K

Në pikat e lëvrim:

Çmimi minimal fillestar për njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent – 2.97 USD/bbl + K

- 75.27 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të naftës (pesha specifike, aciditeti i naftës, % e squfurit).
- Brent është çmimi në \$/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinin e Prokurimit Publik.
- 2.97 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).

- K- është vlera \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal të shitjes të përlogaritur nga formula (Ke⁰).

- Vendndodhja e naftës brut:** Albpetrol sha Patos: Ne pikat e levrimit Stacioni Usoje, Stacioni Visoke, Stacioni Gorisht, Stacioni Zharrez, Stacioni Kuçove, Stacioni Amonice.
- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.
- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit Kati 1 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 03.05.2019, ora 11:00.
- Data e hapjes së ofertave:** datë 03.05.2019, ora 11:00, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

12. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po Jo X

- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, përpara datës dhe orës së zhvillimit të ankandit, në vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, formulari tip dhe dokumentet që duhen dorëzuar

Kompensimi i pronave, ATP: 800 pronarët që marrin paratë

Agjencia: Kostoja e aplikimit, 2 mijë lekë

Të gjithë pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje dhe kanë një vendim për kompensim nga Këshilli i Ministrave, për të marrë kompensimin duhet të plotësojnë formularin tip dhe ta dorëzojnë atë në Agjencinë e Trajtitit të Pronave. Janë në total 800 pronarë, për të cilët qeveria ka miratuar kompensimin për secilin prej tyre. "Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituese ka filluar dhe nuk do të jetë i kush-tëzuar dhe i kufizuar në kohë", - thuhet në njoftimin e ATP-së. Pronari apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesën tip, që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Subjektet përfituese, kërkesa e të cilëve nuk është pranuar për mungesë dokumentacioni gjatë procedurave të mëparshme, kanë të drejtë të riaplikojnë. Këto subjekte nuk paguajnë tarifë shërbimi, nëse provojnë pagimin e saj gjatë aplikimit të mëparshëm.

PRANIMI I KËRKESAVE

Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimit dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërbimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës

- ### DOKUMENTET
1. Kërkesa tip që vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë ATP-së, të plotësuar sipas rubrikave.
 2. Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi (në rast se subjekti përfitues ka vdekur).
 3. Prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre. Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët për pjesën takuese në pronën që kompensohet.
 4. Vërtetimin original i lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare dhe IBAN-in përkatës.
 5. Fotokopjen e dokumentit të identifikimit.
 6. Certifikatën familjare të kërkuarit/aplikuesit.
 7. Mandat pagesa për shumën 2000 lekë për çdo aplikim të veçantë.

për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i Përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës, nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfshihen në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.

DOKUMENTET

Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së Tiranë kërkesën tip, që i vihet në dispozicion nga grupi i punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjesë të tyre, për çdo aplikim të kryer paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

KOMPENSIMI I PRONARËVE

Emër	Atësi	Mbiemër	ENGJELLUSHE	SHAHIN	HURMA	DERVISHI	DISHA	IKBAL	QOSJA
			DUZHA		ZHULJETA	MUSA BALLIU	SHQIPE SULEJMAN DISHA	TOMORR	QOSJA
HATIXHE	SHAHIN	TOÇILA	BAJAME DALIP	DERVISHI	ARDJANA	DERVISHI	MAJLINDA SULEJMAN DISHA	RASIM	QOSJA
SELIM	SHAHIN	DERVISHI	NEXHMIE DALIP	BEQIRI	KLEJVI	AGRON DERVISHI	LLAMBI STAVRI JORDANI	HAXHIRE	QOSJA
ZADE	SHAHIN	LAMI	AGIM DALIP	DERVISHI	XHORXHINA	AGRON	LIVAN QOSJA	LUIZA	QOSJA
HAVA	SHAHIN	XHEPEXHIU	FATOS DALIP	DERVISHI	DERVISHI		MYZEJEN KRASNIQI	ILIRJAN	QOSJA
LULJETA	SHAHIN	KUMRIA	FLORA DALIP	HYSA	ELIDA	MUSADERVISHI	FATIME KRASNIQI	AGRON	QOSJA
HAJRIE	DERVISHI		MANUSHE	DERVISHI	BRUNILDA	MUSA BAJRAMI	SKENDER KRASNIQI	XHELALMYRTEZA	TUPI
ENEIDA	RAMAZAN	DERVISHI	SUZANA	HAJDAR ÇEKREZI	KLODIANA	MUSA JAUPI	ISMETE KRASNIQI	ALI	JAKUP MYSLIHAKA
ENXH	RAMAZAN	DERVISHI	FATMIR	HAJDAR DERVISHI	BEJAZE	TARE TATA	BEDRIJE KRASNIQI	LLAMBI	SIMON BULI
TAIBE	SHAHIN	DERVISHI	ANILA	HAJDAR DERVISHI	TRANE	OSMAN DISHA	QEMAL KRASNIQI	VEZIKO	HEKURAN HASA
KADRI	SHAHIN	DERVISHI	LILJANA	HAJDAR DERVISHI	PERPARIM	SULEJMAN	XHEVAHIR KRASNIQI	HIDAJETE	VEHBI

GLADIOLA AGRON	LINDITA BALLA	DIANA ESAT CORAJ	XHEVRIJE KATROSHI	SAIMIR	ARAPI
STRINGA(DAKLI)	(METANI)	ZHAKLIN ESAT BELIU	ADILE JAHO	LEFTERI	SHKURTI
LUMNIJE ZIJA	NAILE METANI	ZHENI ARBEN TREBICKA	AGIM JAHO	EVALDA	CHIARELLA
LUNIKU(MUÇA)	(DERHEMI)	LEIF ABDULLA XHAVID	EDMOND JAHO	EVALDA	CHIARELLA
MERITA MUSTAFA	ZAMIRA	BALIU	FATMIRA DYRMYSHI	EVALDA	CHIARELLA
LAMÇJA(DURO)	KLEMENDI(DERHEMI)	MYZEJEN ABDULLA	(JAHO)	EVALDA	CHIARELLA
PRANVERA AZMI	ARJAN DERHEMI	KAZAZI	GEZIM JAHO	EVALDA	CHIARELLA
HAMZAJ(STRINGA)	INDRIT DERHEMI	ADNAN DIBRA	INDRIT JAHO	EVALDA	CHIARELLA
VJOLLCA ZIJA LUNIKU	EVA TOCI	ARTAN DIBRA	MUHAZES JAHO	EVALDA	CHIARELLA
LILJANA MUSTAFA	(DERHEMI)	ASTRIT TOPTANI	NEXHMIJE JAHO	EVALDA	CHIARELLA
LAMÇJA(BIÇOKU)	KUDRETE ELBASANI	BIBIKA STAROVA	MIMI JAHO	EVALDA	CHIARELLA
BENON MUSTAFA LAMÇJA	IRMA SHEHAJ	BONIN TOPTANI	AGRON SKENDERI	EVALDA	CHIARELLA
BRIKENA SEZAI	MALIQ MAHMUT Tafa	DASHURI DIBRA	BASHKIM PINARI V.	EVALDA	CHIARELLA
HAXHIADEMI(BAXHAKU)	ALBANA SELFO DEMI	DRITA BOBRATI	BASHKIM KACA	EVALDA	CHIARELLA
ALEMSHA AZMI	ARMANDO SELFO	ELDA KONOMI	EDMOND MEMA	EVALDA	CHIARELLA
BOLLANO(STRINGA)	MOSHO	ELISABETA TOPTANI	JALLDIZ MEMA	EVALDA	CHIARELLA
SHQIPONJA AGRON KUSI	BARDHYL MUMAJESI	FUAT LIBOHOVA	LULZIM KACA	EVALDA	CHIARELLA
DANJELA DURIM KUSI	MAKSIM MUMAJESI	GAZMEND DIBRA	RITA MEMA	EVALDA	CHIARELLA
GEZIM DURIM KUSI	MUBAREQ MUMAJESI	GENCI DIBRA	YLLI MEMA	SABRI	SHALA
KEJSI DURMI KUSI	BAJRAM MUMAJESI	HIRMA DIBRA	MURAT IHSAN	MERITA JAVER	SHALA
PULLUMB QOSJA	NAILE MUMAJESI	ILIR DIBRA	CA	SABRI MYSLIM	SHALA
HAMIDE RUSHEKU	MIRJAN MUMAJESI	KADRI LIBOHOVA	SILVANA IHSAN	MERITA JAVER	SHALA
	MILUKA MUMAJESI	LIMANE ORGOCKA	PODGORICA	SABRI MYSLIM	SHALA
NADIRE MYSLYM KELLEZI	EDMOND MUMAJESI	LUAN DIBRA	TAULANT IHSAN	URFI RUZHDI	AGOLLI
AGIM EMIN MUCA	ELVIJE VOGLI	LULZIM TOPTANI	PODGORICA	BERNARD	CAUSHAJ
ILIR EMIN MUCA	BASHKIM ARBANA	MELI KELLICI	XHEVDET QAZIM	EDUARD	CAUSHAJ
LUCIE DOMA	ISLAM ARBANA	NASIBE QOSE	LIBOHOVA		
REXHEP DOMA	KRYEGHYSHATA BOTERORE	NERMIN DIZDARI	BRIGITA XHEPA	YLLKA	TALO
SABRIJE DOMA	BEKTASHIANE	RAHMI QORALIU	KURT QAZIM XHEPA	LIRI	RISTA
KOMUNITETI MYSLYMAN	KRYEGJYSHATA BOTERORE	TEFTA BABAMETO	ARIANA PILIKA	NATASHA	DEMIRI
BUKURIE KOKONOZI	BEKTASHIANE	VERA HAKIU	TAKUINA ADAMI	ATHINAJA	NDINI
SULEJMAN KOKONOZI	ALDA TOPTANI	XHIMI DIBRA	ARIANA PILIKA	VASILIKA	MALAJ
MEHEMT ILJAZI	ARDIAN TOPTANI		TAKUINA ADAMI	NATASHA	PETANI
SULEJMAN ILJAZI	FADIL TOPTANI	ESAT FEVRI PAZARI	ISMAIL ALI GJINI	KLAUDIA	PETANI
KRYEGJYSHATA BOTERORE	LUMTURI TOPTANI	VIOLETA FEVRI KAZA-	ISMAIL ALI GJINI	ERVIS	PETANI
BEKTASHIANE	MYNEVERE TOPTANI	ZI (PAZARI)	DHURATA KALTANI	VASILLAQ	DHAMO
	VERA TOPTANI	KOMUNITETI MYSLIMAN	HADIJE OSMANI	SEDAT	LIBOHOVA
YY ALBANIA DEVELOPLTD	XHULI TOPTANI	ATLLIJE YLLI	ISMETE KALTANI	SOFIE	GJIKA
CONSTRUKSION	REFIK HAXHI ABAZI	BILAL BOGDANI	ALMA GJELI	PJERETA	ÇIKA
LINDITA DUSHMANI	BARDHYL ABAZI	DIANA BEQIR BIBA	BUJAR OSMANI	REFAT	FRASHERI
ZHULIETA BESIM HA-	FATIME DEDJA	ELDA RAKIP BOGDANI	BURBUQE ARUCI	SHOQERIA RDA	PETROL SH.A
RASANI	HATIXHE BALLA	ELVI AGRON BOGDANI	ELMIRA HAJDARI	HATIXHE	ALI KRAJA
MUHAMET ISMAIL SHPATI	HAZIZ ABAZI	ENIDA BOGDANI	MUHAMED OSMANI	YMER XHAFFER	KRAJA
ARBEN BESIM SINA	KAJE MUMAJESI	FATMIR BOGDANI	HEKTOR OSMANI	QEMAL XHAFFER	KRAJA
OSMAN HYSEN KOKOLI	KUMERI BALLA	RAMAZAN BOGDANI	HELIDON OSMANI	BAHRI XHAFFER	KRAJA
SKENDER ISMAIL SHPATI	MALIQ ABAZI	RESHAT BOGDANI	NADIRE OSMANI	BEQIR XHAFFER	KRAJA
KUJTIM ISMAIL SHPATI	MUHARREM ABAZI	SAIMIR KADRI BIBA	ALMA GJELI	ENVER XHAFFER	KRAJA
QEFSERE ISMAIL ZHEGU	MUSA ABAZI	ENIDA BOGDANI	BUJAR OSMANI	HAVA XHAFFER	KRAJA
PETRIT ISMAIL SHPATI	OSMAN ABAZI	ELDA RAKIP BOGDANI	BURBUQE ARUCI	HAMIDIJE	XHAFFERKRAJA
VJOLLCA ISMAIL DUSH-	RAZIJE RAUFI	ELVI AGRON BOGDANI	ELMIRA HAJDARI		
KU	SHEQERE ABAZI	ATLLIJE YLLI	MUHAMED OSMANI	DRITAN MUHAMET	KRAJA
FATMIRE ISMAIL VATHI	SHERIFE ABAZI	BILAL BOGDANI	HEKTOR OSMANI	FATJON MUHAMET	KRAJA
HYSEN OSMAN KOKOLI	VELI ABAZI	DIANA BEQIR BIBA	HELIDON OSMANI	AFERDITA MUHAMET	KRAJA
DURIM OSMAN KOKOLI	XHARIJE ABAZI	FATMIR BOGDANI	NADIRE OSMANI		
ALMA OSMAN KOKOLI	XHEMILE ABAZI	RAMAZAN BOGDANI	FONDI BESA SH.A	FATIME XHAFFER	KRAJA
BRIKENA OSMAN KOKOLI	HAXHIRE BAKALLI	RESHAT BOGDANI	ERALD BERHOMI	NUSRET SAIT	GURRA
HAXHI DERHEMI	EDUART SALI BELIU	SAIMIR KADRI BIBA	AISHE ARAPI	AISHE	GURRA
HASAN DERHEMI	GANI ABDULLA BELIU	DESHIRA GREVA	BURHAN ARAPI	AGIM	GURRA
SANIE DERHEMI	MERITA SALI BAKIU	HAJDAR ZELA	DHURATA ARAPI	EQEREM	GURRA
MAKBULE DERHEMI	RAMAZAN ABDULLA	QEFSERE RUSHEKU	KADRI ARAPI	MELIHA	GURRA
EDLIRA METANI	BELIU	VJOLLCA VOKSHI	LEJLA ARAPI	GENC	GURRA

YMER REXHEP PENI	RITA SHERIF FRASHERI	HYSEN ISMAIL CENOMERI	VALENTINA HEKURAN	BUKURIE SHABA
DEMIR REXHEP PENI		MEHMET ISMAIL	BARXHA	NEXHMIJE SHABA
BEKIM SHYTI	ROBERT RITVAN GAJDA	CENOMERI	PETRIT HEKURAN KURA	MARJANA SHABA
MUHAMET SHTALBI	FATBARDHA SELMANLEKA	ZIJA ISMAIL	LUMTURI HEKURAN	LEJLA SHABA
DRITA MUHAMET RAMA	SHPRESA SHAQIR BARDHI	CENOMERI	ALIU	MERITA BEGA
ESHREF MUHAMET	HILMI HAMIT SHIN-	IBRAHIM CULLHAJ	SHQIPONJA HEKURAN	ARBEN SHABA
SHTALBI	GJERGJI	SULLTANE SHIMA	KURE	SILVANA KASEMI
ISMAIL MUHAMET	SHEMSI RAKIP MANJANI	IDRIZ CULLHAJ	MENEKSHE HEKURAN	CAJE KURDARI
SHALBI	TEUTA SHEMSI MANJANI	REXHEP CULLHAJ	FECANJI	IBRAHIM RAMAZAN
LUAN HAKI HASEQUI	SOKOL SHEMSI MANJANI	LUTFI CULLHAJ	FLORA HEKURAN	KURDARI
FATMIR HAKI HASEQUI	ILJAZ SHAQIR LLATJA	SHERIF CULLHAJ	SANXHAKU	MYSLYM RAMAZAN
SHAHU HAKI HASEQUI	EDLIRA SHAQIR LLATJA	EMINE SHIMA	ARDI VELEDIN KURE	KURDARI
VJOLLCA SHEFQET	ERMIRA SHAQIR LLATJA	FATIME CULLHAJ	KRISTEL VELEDIN	HAVA RAMAZANKURDARI
HASEQUI	BOIKEN ARDIAN LEKA	SADETE CAUSHI	KURE	HAXHIRE RAMAZAN
KLEVIN FERDINAND	FLORIANA ARDIAN LEKA	HURMA CULLHAJ	FESTIM BANUSH IBRALIU	MALAJ
HASEQUI	TRITAN MIRDASH KALO	VAJE CULLHAJ	BESNIK HASAN	HYSNI DERVISH BARZIU
ENE FERDINAND	LULZIM MIRDASH MOLLO-	RAMAZAN CULLHAJ	HYSENBELLI	ILIRJANSETALI MANE
HASEQUI	HOLLI	REFIK CULLHAJ	FETAH ASLLAN FERATI	SHERIF TOQI
IBRAHIM TOPTANI	SPARTAK XHAFERR	GEZIM CULLHAJ	BESNIK ASLLAN FERATI	BASHKIM TAFANI
LILJANA SHERIF	BAKLLAMAJA	SERVETE KECI	AFERDITA YMER TRESA	FADIL VELI KUMEZINI
SHTINO	ISAVETA QAMIL LEQEJZA	SANIJE CULLHAJ	BAJAME YMER TRESA	
ILONA VASIFZISO	MIGEN RITVAN GAJDA	ZONJE SHKRETA	FATOS YMER GJATA	XHEMAL HALIL HOXHA
VIVIANA PETRIT	ALFRED QAMIL MUZHAKI	SHPRESA ISUFI	FLAMUR YMER GJATA	HAMIT AVDI GJELDIKU
TOPTANI	DASHAMIRA QAMIL	FLUTURA KAXHAJA	ISLAM YMER GJATA	NAIM QAZIM LULI
QAMIL HYSEN BIÇAKU	CENGELI	KUJTIM CULLHAJ	LAJE YMER ALLA	FADIL ALI DERVISHI
GJINOVEFA MUSTAFA	"FLORIKA"(GJEIRGJETA)"	MIMOZA CULLHAJ	LILJANA YMER KODRA	MYSLYM MALI
BIÇAKU	KOSTANDIN MOLLOHOLLI	ASTRIT CULLHAJ	MIMOZA YMER KRAS-	GANI BILALI
NERAIDA HYSEN	GENC ALI MOLLOHOLLI	MIRELA CULLHAJ	NICA	XHEMAL BILALI
TAUSHANI	LOLITA ALI BUSHATI	BARDHA CULLHAJ	NADIRE YMER HASA	HAZIZ QAZIM TERZIU
LUM-MIR SHERIF	NADIRE BAJRAM MOLLO-	HANE CULLHAJ	QARKU TIRANE	Besnik Hysi
FRASHERI	HOLLI	ARBEN CULLHAJ	QARKU TIRANE ZONA KAD	Kompensimi i Pronarëve
RITA SHERIF FRASHERI	FATBARDHA ABDYL LOLJA	BAJRAM CULLHAJ	QARKU TIRANE ZONA KAD	Androniqi Jorgji Dalla
MEHMET SEBAUDIN DERVISH	HYSEN ABDYL MOLLOHOLLI	EMINE SHIMA	ALTIN SHABA	Stavrulla Jorgji Dalla
BIÇAKU	ESMERALDA ABDYL	FATIME MANÇAKU	SHABAN SHABA	Jorgji Jorgji Dalla
AHMET SHYQËRI DERVISH	MOLLOHOLLI	GEZIM CULLHAJ	LAVDIM GEZIM SHABA	Aleksandra Jorgji Dalla
BIÇAKU	MEDIHA OSMAN BARDHI	IBRAHIM CULLHAJ	XHEVDET SHABA	Janulla Kapurani
EVELINA PETRIT QYQJA	(PULLAZI)	IDRIZ CULLHAJ	QARKU TIRANE ZONA KAD	Garufu Vasiliu
SEFEDIN SHYRI	BESNIK OSMAN PULLAZI	LUTFI CULLHAJ	QARKU TIRANE ZONA KAD	Marina Qosa
BIÇAKÇIU	ARBEN OSMAN PULLAZI	RAMAZAN CULLHAJ	BEDRI ISUF BALI	Camato Muka
REFIK PETRIT TOPTANI	AGIM OSMAN PULLAZI	REFIK CULLHAJ	LUMTURI ISUF BITRI	Fotino Papa
GJINOVEFA MUSTAFA	MEREME OSMAN PULLAZI	REXHEP CULLHAJ	VJOLLCA ISUF BIBAJ	Foto Hasimi
BIÇAKU	MEDIHA OSMAN BARDHI	SADETE CAUSHI	RAZLJE ISUF MYRAZI	AHMET HASAN HAXHIA
QAMIL HYSEN BIÇAKU	(PULLAZI)	SERVETE KECI	FATBARDHA ISUF MATUKA	
NERAIDA HYSEN TAUSH-	BESNIK OSMAN PULLAZI	SHERIF CULLHAJ	ALTIN SHABA	MAKSIM GEGA
ANI	PETRIT OSMAN PULLAZI	SULLTANA SHIMA	SHABAN SHABA	PERPARIM GEGA
MEHMET SEBAUDIN DERVISH	ARBEN OSMAN PULLAZI	VJOLLCA TROPLINI	LAVDIM GEZIM SHABA	FATO MASKAJ
BIÇAKU	AGIM OSMAN PULLAZI	Ilarja Sokol Marku	XHEVDET SHABA	MIRJETA ALIM
ILONA VASIFZISO	MEREME OSMAN PULLAZI	QARKU K ORÇË,	DALLENDSHE SHABA	XHELAJ
AHMET SHYQËRI DERVISH	ADEM MUHARREM JOCA	ZVRPP KORÇË,	DRITA SHABA	FJONA FATOS DOLLANI
BIÇAKU	MAHMUDIJE MUHARREM	ZONA KADASTRALE 8564	ENVER RADA	SILVANA ALIM ALIKE
VIVIANA PETRIT TOP-	JOCA	GANI IDRIZ AGA	LULZIM HOXHA	ZAMIRA VELO
TANI	BEDRI ISMAIL CENOMERI	AGIM MUHARREM QELE-	ALFRED SHABA	
EVELINA PETRIT QYQJA	ETHEM ISMAIL CENOMERI	POSHI	EDMOND SHABA	EDLIRA KUTA (SIJONI)
IBRAHIM TOPTANI	HYSEN ISMAIL CENOMERI	ASTRIT HAMDI BILALAJ	BAKUSHE REXHEP SHABA	IDAJETE KORRIKU
SEFEDIN SHYRI	MEHMET ISMAIL	VALDET HAMDI BILALAJ	MUHAREM REXHEP SHABA	(SIJONI)
BIÇAKU	CENOMERI	ASTRIT HAMDI BILALAJ	ISMETE RADA	MYZEJEN BAXHAKU
LUM-MIR SHERIF FRASH-	ZIJA ISMAIL CENOMERI	KRYEGJYSHATA BOTERORE	PRANVERA RADA	(SIJONI)
ERI	BEDRI ISMAIL CENOMERI	BEKTASHIANE	JUSUF RADA	RUZHDI SIJONI
LILJANA SHERIF SHTINO	ETHEM ISMAIL CENOMERI	INXHI RIZA KURA	SULLTANE SHABA	SHYQYRI SIJONI

SAMITI I BERLINIT DEBATET

Hashim Thaçi: Pajtimi, i pamundur nëse Serbia nuk na njeh pavarësinë

Samiti i Berlinit, ç'ndodhi me dialogun Kosovë-Serbi

Merkel e Makron: Të shqyrtojmë mundësitë e të heqim tensionet

Ditën e djeshme është mbledhur Samiti i shumëpritur i Berlinit, me ftesë të Makronit dhe Merkelit, për të bërë një tentativë tjetër për dialogun Kosovë-Serbi. Pas takimit që pati me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, përfaqësuesja e BE-së për Politikë të Jashtme është takuar edhe me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Ai ka ndarë detaje nga Samiti i Berlinit i mbajtur dje në Gjermani. Përmes një postimi në faqen e tij të "Facebook", Thaçi shkruan se situata e keqe në të cilën ndodhet vendi nuk mund të tejkalohet vetëm me deklaratat dhe premtimet abstrakte. Ndër të tjera, Thaçi shpreh se është e padrejtë që Kosova të mbetet vendi më i izoluar në Europë, në një kohë që populli i saj është më proeuropian në rajon. "Në hapjen e Samitit të Berlinit fola për bashkëpunimin rajonal dhe pajtimin. Situata dhe relacionet janë në nivel të ulët, prandaj në rrethana të tilla shumë iniciativa të mira nga Procesi i Berlinit kanë mbetur pa u realizuar. Kjo situatë e keqe nuk mund të tejkalohet vetëm me deklaratat dhe premtimet abstrakte. Duhet vendime të guximshme nga shtetet e rajonit, të cilat nuk do të ndodhin për aq kohë sa nuk ka vendime të guximshme dhe strategjike nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare. Edhe pajtimi do të jetë i pamundur për aq kohë sa Serbia dhe Bosnje e Hercegovina nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Gjermania dhe Franca kanë mundësi ta marrin lidhshin për këto vendime të guximshme. Por, një prej vendimeve të para që Bashkimi Evropian do të duhet ta merrte është liberalizimi i vizave për qytetarët tanë. Kosova padrejtësisht ka mbetur vendi më i izoluar në Europë. Qytetarët e Kosovës janë populli më proevropian në rajon dhe është shumë e padrejtë të vazhdojmë të diskriminojmë", shkruan Thaçi. Ai ka bërë të ditur se presin nga kancelarja gjermane, Angela Merkel që ta bindë presidentin serb ta njoh Kosovën. Për takimin ka njoftuar edhe zëdhënësjë e BE-së, Maja Kocijančič përmes rrjetit social "Twitter". Ndërkaq, në një prononcim për mediat, krah kryeministrit Ramush Haradinaj, presidenti Thaçi tha: "Kosova është shtet i pavarur dhe nuk mund të ketë negociata pa praninë e Shteteve të Bashkuara. Kosova është shtet i pavarur sovran. Preshevi, Bujanoc të gjithë jemi Kosovë". Nga ana e tij, kryeministri Ramush Haradinaj mohoi se ekziston një draft i konkluzioneve të Samitit të Berlinit. "Me rëndësi është se Kosova ka qëndrimet e veta, pra edhe sonte do të jemi në nivel të përgjegjësive tona. Nuk ka ndonjë draft apo dokument. As nuk kemi rënë dakord, as nuk kemi folur, por më shumë rëndësi ka ajo kemi thënë çdo



Pamje nga takimi i Samitit në Berlin

herë: Kosova ka qëndrimet e veta, besoj se do të jemi në nivel të përgjegjësive tona", tha Haradinaj. Ndërkaq, kancelarja gjermane Angela Merkel porositi që zgjidhja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk duhet "të bëhet në dëm të vendeve tjera të rajonit". Në një konferencë për media së bashku me Presidentin e Francës, Emmanuel Makron, si mikpritës të Samitit të Berlinit, Merkel tha se në kuadër të këtij samiti do të diskutohet hapur për të gjitha sfidat. "Jemi të përkushtuar për perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit, por kjo s'ka të bëjë me zgjerimin. Gjermania e Franca duan të tregojnë se është në interes të përbashkët që të shohim zhvillimin e Ballkanit. Do të diskutojmë se si mund ta gjejmë një zgjidhje për Kosovën dhe Serbinë. Ideja jonë është që të shohim se si të pajtohemi për t'i lehtësuar e jo vështirësuar gjërat. Nuk do të ketë ndonjë vendim", tha Merkel. Nga ana e tij, Presidenti i Francës, Emmanuel Makron gjithashtu porositi që në kuadër të samitit të diskutohet hapur për të gjitha opsionet që janë në tryezë për sa i përket Serbisë dhe Kosovës. "Nuk e kemi për qëllim të imponojmë zgjidhje për Beogradin dhe Prishtinën. Ne dëshirojmë të shqyrtojmë të gjitha mundësitë, por edhe të shmangim tensionet e mundshme në rajon, të cilat mund të ndodhin për shkak të opsioneve që janë në tryezë", tha Makron. Merkel dhe Makron përmendën marrëveshjen për

emrin mes Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut si një shembull të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes vendeve të rajonit. Ndërkohë, dy liderët e vendeve të fuqishme evropiane, Gjermanisë dhe Francës zhvilluan një darkë pune të përbashkët me delegacionet nga Kosova dhe Serbia. Ndërkaq, Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq pas takimit me Mogherinin tha se duhet të ketë një zgjidhje kompromisi. "Nëse askush nuk dëshiron kompromis dhe mendon se duke bërë presion mbi Serbinë vjen të zgjidhja, atëherë këtu përfundon filmi", u shpreh Vuçiq. I pyetur për çështjen e ndryshimit të kufijve, Vuçiq tha: "Kur bëhet fjalë për çështjen e ndryshimit të kufijve, pyetja ime është 'cilët kufij?', ata që njohin Kombet e Bashkuara, Spanja apo Italia?". Gjermania e njoh Kosovën si shtet, ndërsa Serbia nuk e njeh sikurse nuk e njohin Kina, Rusia, India. Pikërisht për këtë unë them se duhet gjetur një zgjidhje kompromisi", tha Vuçiq. Ai ka kërkuar sërish heqjen e tarifës ndaj mallrave serbe dhe të Bosnjës si mundësi e vetme për vazhdimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë. Samiti i Berlinit i shënon takimin e parë të drejtpërdrejtë të udhëheqësve të Kosovës dhe Serbisë që nga nëntori i vitit të kaluar. Kur bisedimet e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian u ndërpreën për shkak të vendosjes së tarifës ndaj mallrave serbe nga ana e qeverisë së Kosovës.



Çfarë mund të pritet nga takimi i Berlinit?

Megjithëse takimi është joformal, pritet që të ketë një dokument, ku do të përmbledhen rezultatet përfundimtare të takimit, të cilat do të firmosen nga të gjithë pjesëmarrësit. Dje kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe presidenti francez Emmanuel Makron priten në Berlin krerët e qeverive të Ballkanit Perëndimor, Sllovenisë dhe Kroacisë. Ndryshe nga ajo që thuhet në media, një marrëveshje për ndryshimin e territoreve në Ballkan nuk pritet të ketë - i tha 'DW'-së një zyrtar i qeverisë gjermane. Madje, nuk mund të pritet as edhe një marrëveshje konkrete përsa i përket normalizimit të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës. Edhe zëdhënësjë e qeverisë gjermane, Ulrike Demmer, tha të premtën se takimi synon shkëmbimin e mendimeve dhe ka karakter joformal. Demmer konfirmoi se Kosova është një nga temat kryesore. Sipas burimeve të 'DW', Kosova do të jetë tema kryesore gjatë darkës, pra në pjesën e dytë të samitit. Gjermania pritet të kërkojë nga qeveria e Kosovës që ajo të heqë taksat doganore prej 100 për qind të vendosura ndaj Serbisë dhe Bosnjës, sepse pa to nuk mund të ketë vazhdim në dialogun e normalizimit.

REAGIMET

ANGELA MERKEL

"Jemi të përkushtuar për perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit, por kjo s'ka të bëjë me zgjerimin. Gjermania e Franca duan të tregojnë se është në interes të përbashkët që të shohim zhvillimin e Ballkanit. Do të diskutojmë se si mund ta gjejmë një zgjidhje për Kosovën dhe Serbinë. Ideja jonë është që të shohim se si të pajtohemi për t'i lehtësuar e jo vështirësuar gjërat. Nuk do të ketë ndonjë vendim sonte", tha Merkel.

EMMANUEL MAKRON

"Nuk kemi për qëllim të imponojmë zgjidhje për Beogradin dhe Prishtinën. Ne dëshirojmë që të shqyrtojmë të gjitha mundësitë, por edhe të shmangim tensionet e mundshme në rajon, të cilat mund të ndodhin për shkak të opsioneve që janë në tryezë", tha Makron.

ALEKSANDAR VUÇIQ

"Nëse askush nuk dëshiron kompromis dhe mendon se duke bërë presion mbi Serbinë vjen të zgjidhja, atëherë këtu përfundon filmi. Kur bëhet fjalë për çështjen e ndryshimit të kufijve, pyetja ime është 'cilët kufij', ata që njohin Kombet e Bashkuara, Spanja apo Italia?". Gjermania e njoh Kosovën si shtet, ndërsa Serbia nuk e njeh, sikurse nuk e njohin Kina, Rusia, India. Pikërisht për këtë, unë them se duhet gjetur një zgjidhje kompromisi", tha Vuçiq.

HASHIM THAÇI

"Pajtimi do të jetë i pamundur për aq kohë sa Serbia dhe Bosnje e Hercegovina nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Gjermania dhe Franca kanë mundësi ta marrin lidhshin për këto vendime të guximshme. Por, një prej vendimeve të para që Bashkimi Evropian do të duhet të merrte është liberalizimi i vizave për qytetarët tanë. Kosova padrejtësisht ka mbetur vendi më i izoluar në Evropë. Qytetarët e Kosovës janë populli më proevropian në rajon dhe është shumë e padrejtë të vazhdojmë të diskriminojmë!", shkruan Thaçi.

RAMUSH HARADINAJ

"Me rëndësi është se Kosova ka qëndrimet e veta, pra edhe do të jemi në nivel të përgjegjësive tona. Nuk ka ndonjë draft apo dokument. As nuk kemi rënë dakord, as nuk kemi folur, por ka më shumë rëndësi ajo që kemi thënë çdo herë: Kosova ka qëndrimet e veta, besoj se do të jemi në nivel të përgjegjësive tona", tha Haradinaj.

Rrëfëhet këngëtari: Familja dhe pasioni, do të largohem kur zëri të më lërë

Rikthimi i fuqishëm i Ratit, ja e veçanta e projekteve të reja

"Nuk do eksperimentoja kurrë me muzikën operistike"

Egla Xhemali

Prej vitesh ai është një nga këngëtarët më të dashur për publikun shqiptar dhe jo vetëm. Një rikthim që mezi është pritur nga fansat e tij do të vijë plot të papritura. Plaurent Shushku, ose siç njihet nga të gjithë Rati, vjen në një rrëfim për "Gazeta shqiptare" për të hedhur dritë për mungesën e klipëve, punën intensive, koncertet dhe jetën përtej ekranit. Rati nuk njih kompleksë kur na tregon për momentet e sikletshme në performancat 'live' dhe si e ka kthyer situatën në favor. Ndër të tjera, me të qeshur pohon se nuk do eksperimentonte kurrë me muzikën operistike. Një zë potent si i tiji mbetet brenda rrymës që e përfaqëson më së miri. Pauza që ka zgjedhur të bëjë në ekran është në fakt një energji, që shumë shpejt do preket nga ata që e duan muzikën e tij, pasi projekte të reja do i shtohen repertorit të këngëtarit. Kurrsesi nuk do largohet nga muzika. Për të, ajo është e domosdoshme si ajri apo si gjaku që rrjedh në vena. Më tej, artisti na njih me pjesën e paeksponuar në media, me familjen e tij. Kur heq petkun e VIP-it, ne vazhdojmë t'i mësojmë një personi solar, të thjeshtë dhe me shpirtin plot ngjyra. Fundja një artist nuk meriton të quhet i tillë, nëse suksesin nuk arrin ta ndajë me publikun e nëse harron veten e fshihet pas dikujt tjetër. Për këtë Rati ngelet ndër artistët e rrallë, që mbart vlera edhe përtej botës magjike të muzikës.

Pranvera është e mbushur me koncerte. Ku i merrni duartrokitjet më të ngrohta?

Kam fatin e madh, që kam shumë dashamirës, që e duan muzikën time dhe u jam falënderues fansave të mi, që në çdo koncert që performoj shpërblehem me duartrokitje të ngrohta.

Momenti më i sikletshëm i një koncerti?

Nuk mendoj se ka ndonjë artist që nuk i ka ndodhur të paktën njëherë të vetme të mos ketë kaluar një moment të sikletshëm në skenë. Mua personalisht më ka ndodhur të kem ngatërruar tekstin e këngës.

Në çfarë rryme nuk do të eksperimentoni kurrë?



Mendoj se me opera. (qesh)

Ka disa kohë që nuk po publikoni klipë. Si qëndron e vërteta e këtij "largimi"?

Kam bërë një pauzë të vogël sa i përket pjesës së klipëve, por nga muzika nuk jam larguar për asnjë moment. Kam pasur angazhime me koncerte e mbrëmje familjare dhe aktualisht po punoj për projekte të reja.

Nga rrjedha e kohës, bashkëpunimi që do e përsërisni?

Hmm... Është pak e vështirë të veçosh nga bashkëpunimet, sepse kanë qenë të pëlqyera për publikun. Po mendoj se ndoshta do të përsërisja me Amardën dhe Artushin.

Çfarë nuk dimë nga jeta juaj përtej ekranit?

Kam një familje të

mrekullueshme, bëj një jetë të qetë dhe jam i lumtur.

Aventura më e rrezikshme që keni kaluar?

Nuk jam tip aventurier, nuk kam kaluar ndonjë aventura të rrezikshme.

Si keni vepruar kur ju kanë bërë një padrejtësi?

Padrejtësi bëhen shumë, por unë mundohem t'i marr gjërat me qetësi. Jam tolerant, nuk "hakmerrem" që t'u



tregoj vendin që meritojnë, por lë të madhin Zot të gjykojë.

Çdo të thotë për ju "merre jetën si të vjen"?

Në jetë eci me parime, edhe pse nuk është asgjë në dorën tonë. Jeta të përball me sfida të ndryshme. Injtan një libri; siç është një faqe, nuk është tjetra. Ka ulje dhe ngritje, të mira e të këqija, por e rëndësishme është t'i

kapërcejmë të gjitha ashtu siç duhet. Çdo gjë që na servir jeta të mundohemi ta bëjmë sa më mirë të jetë e mundur, se fundja nuk e dimë, sot jemi, nesër nuk i dihet. Këtë bëjë edhe unë.

Një arsye për t'u shkëputur përfundimisht nga muzika?

Muzikën e kam në venat e gjakut tim. Prej saj do të largohem vetëm kur zëri të më lërë.



Pas gabimit të Majlindës, Majku zbulon si do ta ketë të dashurën

Majk dhe ish-partnerja e tij, Majlinda Zeka, kanë qenë për një kohë të gjatë në qendër të vëmendjes së mediave rozë, kryesisht pas ndarjes dhe "sulmeve" virtuale ndaj njëri-tjetrit për kujdestarinë e djalit të tyre Roan. Bukuroshja na habiti, pasi postoi gabimisht në profilin e saj një foto të Majk me Roan, megjithatë më pas e fshiu atë. Pasi kaloi njëfarë kohe, postoi të njëjtën foto në profilin në "Instagram" të djalit. Ndonëse dyshja na ka treguar se tashmë marrëdhënia e tyre është përmirësuar dhe janë përqendruar në rritjen e djalit të tyre, duket gjithashtu se ata kanë marrë drejtime të ndryshme dhe sa u përket jetës romantike. Së fundmi, Majk ka postuar një foto ku ka treguar se ai preferon makinat e bardha, e ndërsa vajzat i pëlqen me ngjyrë.



Djali i propozon publikisht Ana Likës, përgjigjja e aktores do ju shkrijë së qeshuri

Ana Lika është një nga personazhet e njohur për natyrën e saj pa komplekse dhe opinionet, të cilat i shpreh gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, padyshim që çdo gjë rreth saj shkakton lajm. Aktorja ka arritur që në rrjete sociale të jetë mjaft e hapur me të gjithë ndjekësit e saj, pasi jo rrallë herë kemi parë se si u kthen përgjigje atyre dhe se është aktive në shumicën e kohës. Por, duket se Ana nga fansat merr një reagim që ndonjëherë i kalon kufijtë e konfidencialitetit. I tillë ka qenë edhe mesazhi nga një 18-vjeçar, i cili thotë: "Do lidhemi bashkë zemër, jetë, unë jam 18-vjeç", - të cilit Anna i është përgjigjur publikisht: "Po zemra dhe të të rris vet pastaj të të bej goxha çun", - i shkruan aktorja me humor.




Pas sherrit me Oriolën, Noizy nuk flet më as me Dafinën

Noizy është reperi më i pëlqyer dhe më i ndjekur në rrjetet sociale. Ai është mjaft aktiv në profilin e tij në "Instagram", ku poston vazhdimisht foto e video nga përditshmëria e tij. Ditët e fundit ka qenë në qendër të vëmendjes së mediave rozë jo vetëm për këngët e tij të reja, por edhe për një zënkë të mundshme mes tij dhe Oriola Marashit, pasi ata nuk ndiqen në "Instagram". Mirëpo siç duket, Oriola nuk është e vetmja me të cilën Noizy nuk flet, sepse gjasat janë që ai t'i ketë prishur marrëdhëniet edhe me Dafina Zeqirin. Jo se po qarkullon ndonjë thashetheme vërdallë, por ata nuk ndjekin njëri-tjetrin në "Instagram". Kujtojmë që së fundmi kanë sjellë dhe një bashkëpunim shumë të suksesshëm, që u prit mjaft mirë nga publiku. Çfarë ka ndodhur me Noizyn dhe Dafinën?



Rasheli arratiset në Mykonos, me kë të ketë shkuar vallë?

Rashel Kolaneci është një ndër femrat me seksin e ekranit shqiptar. Këto ditë të nxehta të muajit prill kanë bërë që shumë personazhe të njohur të shfrytëzojnë fundjavën dhe ditët e pushimit për të marrë rreze dielli. Ndërkohë që bukuroshja është larguar nga vendi ynë për pushime në një ndër ishujt më luksozë, në Mykonos. Kolaneci po kalon disa çaste relaksi nga Greqia nga ku ka publikuar edhe foto në "Instagram". Mirëpo ajo nuk është vetëm, pasi shoqërohet nga modelja e njohur shqiptare Kristin Prengaj. Të dyja vajzat na kanë treguar që janë shoqe të ngushta nëpërmjet komente që i kanë bërë njëra-tjetrës në "Instagram" dhe tashmë kanë gjetur kohën e lirë për t'u relaksuar. Ndërkohë duhet thënë se Kristin nuk është dhe aq aktive në "show bizz"-in shqiptar, ashtu siç ishte para pak vitesh, kur komentohej shumë në mediat rozë.



FOTOGRAFI



Gegë Marubi, 1959



Gegë Marubi, 1932



Gegë Marubi, 1959

GEGË MARUBI

Nga drita kinematografike, te vorbullat komplekse e kolektivizimit

Fatmira Nikolli

Lek Gjeloshi: "Idilet e fundit" dhe dalja nga "kopshtit arkadik"

Nga Parisi i paraluftës së Dytë Botërore, Gegë Marubi kthehej në Shkodër duke sjellë prej andej pastërtinë e shijeve artistike ku mplekseshin finesa, magjia, thjeshtësia dhe njëherësh kompozimi kinematografik i imazheve. "Dritëshkronja" e tij fikson në dhomën e errët imazhet e parisë së qytetit dhe vetë shtetit, bashkë me portretet pasoliniane të burrave e grave, që ecnin më këmbë për orë të tëra për në "Marub". Fondalet e fiksuara në kohë ende të përfshijnë në ndjesitë e një kthimi në ato vite. Me kohën, megjithëse në vitet 1940, ai e modernizoi studion e tij, prejka parisienne po zbehej dhe fotografitë po kuadratoheshin brenda rregullave që kërkonte realizmi socialist. Muzeu "Marubi" ka nisur një cikël bisedash të lidhura me ekspozitën "Dinastia Marubi". Biseda e këtij ishte me përgjegjës in sektori të konservimit dhe menaxhimit të koleksionit, Lek Gjeloshin.

Në qendër të bashkëbisedimit me të pranishmit, ai tregoi "Idilet e fundit" të Gegë Marubit (1907-1984), i formuar pranë vëllezërve Lumière në Paris (1924). Për Gjeloshin, ai përfaqëson një prej momenteve më të rafinuara të koleksionit të Marubëve. Më shumë se Pietro e Keli, ai mund të cilësohet si fotografi që punoi në dy sisteme diametralisht të kundërt: nga ai kapitalist, tek ai komunist. Një transicion social-politik, që lë një gjurmë të fortë mbi individin dhe dëshminë e paraqitjes së tij. Kështu, edhe personazhet e Gegës, fillimisht të përshkruar nga një dritë e tërthortë e kinematografike, i gjejmë në periudhën e fundit gjithnjë e më të standardizuar nga vorbulla komplekse e kolektivizimit. Kjo periudhë për fotografinë e Marubëve shënon daljen përfun-



Gegë Marubi, 1940

ditare prej atij dimensi i idilik, që e kishte karakterizuar në fillësë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", ai sjell udhëtimin e Gegës nga dimensi më lirik i imazhit, te devijimi i botëkuptimit që përfaqësonte për të mundësia e "inskenimit". Nga një punë që sillte referenca të Caravaggios, apo një qasje krejt familjare edhe me pikturën e Vermeer, ai del nga "kopshtit arkadik".

-Çfarë të ka shtyrë të merresh me punën e Gegë Marubit? Janë fillësat e tij në Paris, apo puna që la pas?

Kur Walter Benjamin shkruante për orën e lexueshmërisë e urgjencën e saj intime, përdorte fjalën "Bild", që do të thotë "imazh". Bëhet fjalë për një marrëdhënie të ngushtë me kohën. Imazhi, kështu i kuptuar, mund t'i referohet një veprë arti, dokumenti ose fjale, ku e tashmja dhe e shkuara kanë ditur të gjejnë reciprocitet, mbi njëra-tjetrën, kup-timësinë e tyre. Në këtë plan lexueshmërie orientohet edhe biseda. Ndërsa interesi për Gegën shkon



Gegë Marubi, 1944

përtej saj. Nga njëra anë sepse aktualisht jam përgjegjës i arkivit të muzeut "Marubi", e kontakti me veprat e autorëve që e përfaqësojnë është pjesë e punës sime. Nga ana tjetër, te vepra e tij më duket prirja për një dekadentizëm estetik, e tjetërsuar në mënyrë të pakthyeshme në periudhën e fundit në një dekadencë të zhveshur nga izmi.

-Kur flasim për "Idilet e fundit", e kemi fjalën për punën e

fundme që ai bëri me vullnetin e tij jashtë kuadrateve të realizmit socialist?

Tek periudha e fundit duhet të reflektojmë për rrethanat, dramën personale e kolektive të njeriut, qoftë ky autor apo subjekt i paraqitur. Në kohën kur po punoja për ekspozitën e Angjelin Nënshatit, "Dëshmitar mes dy kohëve" (2018), kam pas rastin të perceptoj tendencën për një fotografi të pafulltur. Kjo e bënte veprën e tij neutrale si në momentet e transicionit të viteve '90 (ku realiteti shpërthen në forma të paparashikueshme), e po aq në periudhën e regjimit, kur ky "realizëm" duhej të ishte detyrimisht "socialist". Një rezultat që për Nënshatin bëhet i mundur edhe nga mjeti i përdorur Natyralizmi i aparatit fotografik nuk ia cenon raportin me ngjarjen e momentin e pranishëm. Kurse tek qasja e Gegës, ku fotografia spostohet drejt një dimensi më lirik të imazhit, diçka që e bën komplekse e abstrakte natyrën e vërtetësisë së fotografisë, kjo nuk ishte më e mundur. Transformimi social-politik, kanonet e detyrueshme të paraqitjes jo vetëm të porositura, por edhe të diktura, ia devijojnë totalisht botëkuptimin që përfaqësonte për të mundësia e "inskenimit".

-Si ndryshoi forma e tij e punës nga kohë në kohë?

Fotografia e Gegë Marubit mbetet një gjurmë rigorozë, pavarësisht ndeshtrashave të kohës. Në periudhën e fundit, i dedikohet tërësisht arkivit të familjes, që nëpërmjet aktit të dhurimit për bënte edhe themelin e Fototekës Kombëtare "Marubi" në vitet '70.

-Sa përthyer artistin i dhomës së errët, nga koha që erdhi nga Parisi deri në fund të jetës?

Mendoj se i gjithë rrugëtimi si fotograf, e në fund si përgjegjës i arkivit, në flet për një personalitet tejet të kthjellët si krijues e si trashëgimtar i "Dritëshkronjës". Përtej hipotezave mbi trysninë e

dhurimit, gjesti i Gegë Marubit ka sot përmasat e një Muzeu Kombëtar të Fotografisë, ku jo vetëm akti, por edhe përkujdesja e skrupuloziteti i tij në transkriptimin e detajeve të regjistrave përcakton strukturën e orientimin tonë në arkiv.

-Ju flisni për të duke e cilësuar një fotograf, që përfaqëson një prej momenteve më të rafinuara të koleksionit të Marubëve. Çfarë e karakterizon?

Drita jo konvencionale, roli që ajo merr në stimulimin e subjektit. Mjafton të kujtojmë portretin e Teofik Pukës (1932) apo të Abdulah Eminit (1944), ku mund të gjejmë referenca aspak të sforcuara nga Caravaggio, tek ikona e një David Bowie "ante litteram". Vetë eksperiencia e tij në Paris (1924), në kurset e "Lumières", nuk e bën të rastësishëm dimensionin kinematografik që kjo shkollë kishte në natyrën e saj. Po flasin gjithashtu për autorin e parë, që sjell e përdor fotografinë më infra të kuqe.

-A e humbi ai atë "dritën e tërthortë kinematografike"?

Në vitet '40, Gegë Marubi modernizon sfondin klasik të studios, duke e transformuar nga njërë skenë idilike e pastorale, në gjurmë gjeometrike. Një gjest rinovues e i guximshëm që i venitet shpejt, nëse shohim fotot që vijojnë. Këtu mund të reflektohet shumë edhe për keqkuptimet e modernizimit... Megjithatë, ky është momenti i daljes së fundimtare të fotografisë së Marubëve prej "kopshtit arkadik" - sic e përkufizon studiuesi Zef Paci habitatin ku shtresa e hierarki të ndryshme shoqërore simbolizoheshin përmes ritualit fotografik. Të vetmet momente - unë preferoj t'i quaj "idilet e fundit", e zbulojnë për herë të parë disa imazhe të tij - mbesin rastet private e informale të jetës së përditshme, ku ai vazhdon të kërkojë dritë e subjekte, të cilat në rast të caktuar mbartin një frymë familjare edhe me pikturën e Vermeer.

FESTIVALI

Magjia e një festivali pasionesh dhe një mësim për ne

Fatmira Nikolli

Det, mal, sporte uji, sporte ajri, 'jeep safari'. Muzikë dhe kinema nën hijen e ullinjve, ushqim fshatç dhe një pastërti, që u ngjan ëndrrave në vendin tonë. Ai është festivali i pasioneve. Nëse ne kemi besuar se të rinjtë në vendin tonë nuk kanë pasione, nëse kemi besuar se hobi ynë më i madh është kafeneja, ky festival na tregon krejt të kundërtën: se i duam sportet dhe se i ushtrojmë ato. Na ka treguar se të rinjtë kanë një jetë përtej kafeneve dhe se kjo jetë është kaq afër natyrës. Nga Piluri më 2017-ën, në Borshin e këtij viti, "South Outdoor Festival" ia ka dalë të pushtojë jugun duke sfiduar çdo aktivitet argëtimi të mbajtur në vend. Arsyet pse SOP është mbreti i festivaleve është jo vetëm përmbajtja e tij por edhe organizimi. Nga datat 26-29 prill festivali ka përfshirë më shumë qindra turistë vendës dhe huaj, që kanë ndjekur sportet dhe aktivitetet e tij. Të 40 aktivitetet krijuan mundësi të shumta për këdo, duke joshur grupe të ndryshme të rinjsh që kanë pasione të ndryshme. Por, në të katërta ditët fusha e madhe e Borshit ku qe vendosur festivali i ngjante një "fushë tenisi". Pse? Sepse pas çdo vakti, një grup 'milingonash' mblidhte mbeturinat e lëna tavolinave ose nëpër bar duke rikrijuar gjelbërimin e fshatit. Nga mbrëmjet e zhurmshme kur kërcëhej me "Elita 5", muzika latine, Venera Lumani e Lind Islami, apo "All in band" në mëngjeset e hershme ku dielli depërtonte mes pemishës, mes fijeve të barit nuk kishte më deri as bishta cigaresh të hedhura shkujdesur një natë më parë. Në të katërta ditët parkimi pranë fushës së SOF nuk la vend për kaos për të gjithë turistët që kishin udhëtuar nga Tirana a rrethet, jo vetëm sepse së pari ishte menduar për parking, por sepse në parking kishte sinjalistikë qarkullimi dhe një grup të rinjsh që koordinonin makinat në hyrje dhe në dalje. Me gjithë pijet që konsumoheshin, mes muzikës deri në orët të vona, nuk pati as incidente. Sepse një kompani 'security' ishte gjithë kohës në monitorim për të shmangur situatat e mundshme. Dhe në fund disa makina policie qëndronin në rrugë për të siguruar rend. Ka shuma arsye pse ky festival është një mësim për ne dhe të gjitha përmbledhen në një frazë: dashuria për jetën. Të jetosh bukur, të jetosh me sporte, të jetosh shëndetshëm, të ushqehesh shëndetshëm, të mendosh për të gjitha grupmoshat, të mendosh deri edhe tek ambulanca. Dhe të mendosh se këto nuk janë përmbajtja e festivalit, por janë detajet

Kreditet
Armand Habazaj

Sportet dhe trashëgimia kulturore, të ndërthurua në një

që bëjnë diferencën në një vend ku festat lënë pas kaos, plehra dhe postera të grisur. 32 aktivitetet të ndryshme të shpërndara përgjatë gjithë Bashkisë Himarë, bënë që shumë prej pjesëmarrësve të shtunën të zhyteshin në ujërat e Porto Palermoms dhe të dielën të ngiteshin për në Nivicë përmes një rruge të pashtruar që 'lidh' Borshin me kanyonin e Nivicës dhe malet e Tepelenës. Natyra a paprekur, rendja drejt lumit të çonte përmes një natyre pothuaj të pashkelur ku gjeje fshatin "e braktisur" mbi kanyon. Fshati tashmë është rimodeluar duke rindërtuar në qendër të tij godinat e rena, por duke ruajtur autenticitetin e tij me gurët e bardhë e zonës, shtëpitë një a dykatëshe. Nivica duket se po rigjallërohet teksa kanyonet janë bërë sport i ndjekur në vendin tonë dhe

shtëpitë e braktisura janë kthyer në bujtina për turistët që udhëtojnë edhe 3 orë nga Borshi për të provuar ushqimet vendase, djathin e deles, byrekun me lakër të egër mes barit të njomë të pranverës. Fshati me historinë mitike ku gjendet dhe tempulli pagan i lisave, duket se rimerr jetë: qendra e tij i ngjan një kalaje modeste, ndërsa diku në fshat gjen edhe tyrbet, një kala e hershme, gjurmët e një qyteze antike dhe grupe arkeologësh që po gërmojnë për të rigjetur lidhjet me të shkuarën. Kthimi prej Nivicës nëpër Kuç e Çorraj të fshes mes maleve derisa rinisë të shfaqet deti. Dhe Borshi është sërish aty me detin e fushën e ku dritat janë ndezur për një tjetër darkë të paharrueshme. Kënde të vogla kanë krijuar në fushë atmosferën e fshatit, diku janë pro-



dhimet e zonës në panair, matanë drita të varura nëpër pemë, diku më tej vezët e Pashkëve dhe lepuri i madh për fëmijë e të rritur. Bari i thatë me dengje shërben si ulësë pranë tapeteve me motive popullore, ndërsa në skenë sheh grupin isopolifonik të Pilurit që mbledh rreth vetes të rinj e të moshuar; dikush për të dëgjuar e dikush për t'u fotografuar. Të këndosh rreth zjarrit, në një mbrëmje pranvere, të bësh joga në det, kur dielli sa ka nisur të lindë, e më vonë të shijosh "windsurfing, Sailing, Individual Sup, Sup Yoga, Sup Race, Jet Pack, Fly Board, Jali Adventure Point (Kayak, Stand Up Paddle). Të lyesh vezët e Pashkëve në grup, pasi je kthyer nga hiking, Climbing, Kayak, Paragliding a Scuba Diving. T'i afroresh 'mensës' në natyrë, ku gjen mjalte të zonës, qumësht e djathë të zonës, byrekë me peta të bëra në shtëpi apo agrume. Çfarë mund të ketë një festival më shumë se sa muzikë të mirë, filma të mirë, ushqim të mirë, organizim të mirë dhe një fshat si Borshi që mbledh për tri net e katër ditë qindra veta për të nisur sezonin turistik me një shembull të jashtëzakonshëm: të jetosh, të shijosh dhe të mbash

pastër? Ky festival është festa e gjithçkaje që mund të shijohet në natyrë, sport, kulturë, traditë, muzikë dhe kulinari. Vendi i festivalit 400 metra nga bregu në të majtë të rrugës së shtruar që të çon në det.

"South Outdoor" është një nisim e GLZ, përmes programit "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale", financuar nga qeveria gjermane. Tashmë në të tretin edicion, ai u përcollti 4 ditë të mbushura me aktivitete sportive e kulturore, muzikë, traditë, natyrë dhe kuzhinë tipike shqiptare. I njohur për potencialet agro-turistike, historinë, kalanë mbi kodër dhe ullishtat, sivjet aktivitetet kryesore u mbajtën mes malit dhe detit, duke lënë shumë ngjarje edhe për Jalën e Porto-Palermos. Organizatorët kishin rezervuar shumë adrenalinë për pjesëmarrësit me disa aktivitete: Trekking, hiking, mountain bike, scuba diving, jeep safari, kayak, stand up paddle, paragliding, 'Hot Air Ballon', 'Trike Flying', 'Gara Stand Up Paddling', 'Sailing', 'Paddleboard Yoga' si dhe 'Individual Stand Up Paddling'.

Opinioni *i* Ditës

Rama doli kokukur nga Merkeli

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... shkurtër, të mbajtur këtë të hënë në kancelari, në Berlin. Po të lexohen me kujdes deklaratat e qeveritarëve shqiptarë, duket qartas se ata prisnin një kamer-dare shpëtimi të minutave të fundit nga Gjermania.

Para takimit, vetë kryeministri duke besuar në një mrekulli "in extremis", i deklaroi "Top Channel"-it se ai do të shprehej pasi të fliste me Merkelin. Ndërsa menjëherë pas tij, Gent Cakaj, që ishte brenda në dhomën e bisedimeve, foli për atë që shpresonte dhe jo për atë që kishte ndodhur, duke thënë se Shqipëria kishte marrë "mbështetjen absolute" të kancelares për hapjen e negociatave.

Në fakt, e vërteta e asaj që ka ndodhur gjendet shumë më pranë informacionit që dha radioja publike gjermane "Deutsche Welle". Ajo i hodhi një dush të ftohtë qeverisë shqiptare, duke dhënë dy arsye se përse negociatat nuk do të hapen as këtë qershor.

Së pari, sepse Franca nuk do të degjojë për këtë para zgjedhjeve për Parlamentin Europian.

Së dyti, sepse Bundestagu gjerman nuk ka kohë të mjaftueshme për të vendosur (që nga publikimi i raportit të progresit të BE-së, më 29 maj deri në samitin e BE-së në qershor), për çeljen e negociatave.

Pra, me një fjalë, furgoni i Rilindjes e humbi edhe këtë stacion.

Por, ajo që nuk kuptohet është se përse qeveria shqiptare shpresoi deri në minutat e fundit siç tregojnë edhe deklaratat e zyrtarëve më të lartë të saj.

E vetmja përgjigje e arsyeshme duhet kërkuar në atë që ndodhi qershorin e kaluar. Atëherë, Anxhela Merkel u përpoq me mish e me shpirt për të zbutur veton e prerë që Franca dhe Holanda do të artikulonin për ne. Ajo bëri ç'është e mundur që "Jo" ndaj Shqipërisë (pikërisht ajo që këtu u festua si "Po" me deklarata dhe shampanjë) të ishte sa më e moderuar dhe jo turpëuese. E kështu u gjet formula që edhe negociatat nuk hapeshin, edhe qeveria shqiptare shpëtonte fytyrën duke thënë se kishte marrë një datë për fillimin e tyre.

Por, që nga ajo kohë ka ndodhur një zhvillim i rëndësishëm. Në prill të 2018-ës, para një takimi në kancelari me Ramën nga diplomatët gjermanë, Edi Ramës iu kërkuua dënimi i idesë së ndryshimit të kufijve në këmbim të mbështetjes së përpërimin europian të vendit.

Rama e pranoi sfidën. Ai hyri në kancelari dhe i foli sy më sy



Merkelit se nuk e mbështeste aventurën e dy presidentëve, serb dhe kosovar. Kjo gënjeshtëri, nuk është se kaloi pa rezultat imediat. Kryeministri shqiptar mori në Berlin premtimin se Gjermania do të angazhohej për hapjen e negociatave të Shqipërisë dhe se ajo nuk do të lejonte në asnjë mënyrë lënie e Tiranës pas Shkupit në

këtë proces.

Por, pas përpjekjes gjermane në qershorin e shkuar, në gusht, Thaçi dhe Vuçiçi e shpallën publikisht idenë e tyre duke marrë edhe miratimin e John Boltonit. Në fillim me hezitim dhe pastaj gjithnjë e më hapur Rama e mbështeti këtë ide. Ai arriti deri aty së të thoshte në mediat ven-

dase se "Merkel sheh interesat e vendit të saj, kurse unë jam kryeministri i Shqipërisë".

Ky qe me sa duket edhe fundi i historisë së dashurisë mes tyre, që në fillim nga mediat e pushetit në Tiranë u paraqit si një raport tejet i privilegjuar. Pas kësaj tradhtie, kancelarja nuk mund të bënte asgjë për ta ndihmuar të preferuarin e saj, që dikur e shkrinte gazit me barsoletat e kohës së komunizmit.

Prandaj, në takimin e kësaj të hënë ajo nuk dha asnjë sinjal nga ato që qeveritarët shqiptarë shpresonin të degjonin. Ajo nuk kishte më as arsye personale, as për t'iu kundërvënë aleatëve të saj që nuk e duan zgjerimin, as për të ndihmuar një kryeministër që e ka të turbullt situatën edhe brenda vendit.

Këtë qershor Merkel nuk do të ketë më angazhimin e një viti më parë, kjo ndoshta edhe falë zhgënjimit nga Rama.

HOROSKOPI

DASHI

Sa më shpejt që të përqipeni të ecni sot, aq më pak do të arrini. Yjet ju nxisin të shijoni vendin ku ndodhni aktualisht dhe jo të përqendroheni në të ardhmen. Kaloni pak kohë sot duke shijuar shpërblimin material të punës suaj të vështirë.

DEMI

E doni vërtet një kohë të mirë, por kohët e fundit jeni ndier shumë i vetmuar. Ndhuni të lirë dhe shijoni momente të qeta. Kjo kërkesë për më shumë privatësi në jetën tuaj është një hap i shëndetshëm drejt të qenit më të qendrueshëm.

BINJAKET

Një mik, në mënyrë graduale, por të sigurt po fiton fuqi në jetën tënde dhe ndoshta duhet të jesh i kënaqur me këtë fakt. Mësoni si ta trajtoni këtë person me respektin që ai ose ajo meriton. Mundohuni të jeni model dirijeti në çdo kuptim të fjalës.

GAFORJA

Sot mund ta gjeni veten mes disa niveleve ekstreme. Këto luhajtje do të testojnë kufijtë e fleksibilitetit dhe durimin tuaj. Përqipuni të tregoni ekuilibër në çështjet e dashurisë.

LUANI

Ju kenë një ndjenjë të fortë të asaj që dëshironi, prandaj mos e humbni kohën. Nëse veproni duke bazaruar të ndjenjat, do të arrija qëllimin tuaj më shpejt. Njerëzit e jetës suaj po ju qëndrojnë pranë, gati për t'ju mbushur me gëzim.

VIRGJERESHA

E meritoni të keni pak argëtim sot dhe energjia e ndritshme, optimiste që është e gjitha mëth just do t'ju ndihmojë të gjeni momente të bukura. Besimi juaj është i lartë dhe ju ndihni shumë fleksibel dhe të adaptueshëm. Është një ditë e mrekullueshme për plane të improvizuara.

PESHORJA

Ndryshimet reale po vijnë në marrëdhënien tuaj. Duket sikur dikush është më në fund i gatshëm të bëjë një hap tjetër në drejtimin e duhur. A jeni gati edhe ju për të ndërmarrë këtë hap? Bilanci është i rëndësishëm.

AKREPI

Dëgjoni zërin e ambicies sot. Ka ardhur momenti që të vini në zbatim planet dhe projektet tuaja. Sa i përket aspektit emocional, duhet të tregoni më shumë kurajë për të shprehur ndjenjat.

SHIGJETARI

Përgatituni për një ditë të mbushur me surpriza. Nëse tregoni angazhimin e duhur, mund të keni rezultate shumë të mira në punë. Sa i përket dashurisë, gjërat nuk duken stabile.

BRICJAPI

Parashikohet të jetë një ditë interesante sa i përket aspektit profesional. Mund të merri propozime të reja, të cilat mund t'ua përmirësojnë situatën ekonomike. Sa i përket dashurisë, mund të takoni një person interesant.

UJORI

Edhe nëse zgjoheni plot energji, sot nuk është një ditë për të arritur sukses. Përqipuni të kaloni më shumë momente në vetmi dhe të reflektoni mbi gjithçka ka ndodhur në jetën tuaj. Edhe sa i përket çështjeve të dashurisë, nuk do të arrija shumë sukses.

PESHQIT

Nëse jeni gati për një aventurë të re në dashuri, gjasat janë që aspekti planetar të jetë favorizues. Aftësitë tuaja udhëheqëse nuk kanë qenë kurrë më të forta se sot dhe do të jetë jashtëzakonisht e lehtë të realizoni planet tuaja.



Ish-trajneri kuqezi analizon Juventusin

De Biazi: Alegrin e shoh shumë të lodhur

Masimiliano Alegri është një nga trajnerët më të nënvlerësuar në Itali për momentin dhe e gjitha kjo pas skualifikimit që pësoi Juventusin nga Ajaksi. Loja e dobët dhe mungesa e rezultateve në Ligën e Kampi-

onëve e kanë kryqëzuar Alegrin, bashkë me Adanin, analistin e "Sky", me të cilin kishte debate të forta. Në mbrojtje të tij erdhi ish-tekniku i Kombëtares, Xhani De Biazi, i cili foli përpara mediave italiane. "Të

mund të thuhet është në aspektin fizik, me skuadrën që mbërriti në kushte jo optimale në sfidën ndaj Ajaksit", është shprehur De Biazi. "Mungesa e Douglas Kostës dhe Kuadrados ishin të rënda, pasi bëhej fjalë për dy lojtarë të rrezikshëm në fushë. Alegrin e shoh shumë të lodhur nga fakti se u përgjigjet gjithnjë të njëjtave pyetje", ka përfunduar ish-tekniku i Kombëtares shqiptare.

Francezi ishte një "meteor" në Korçë, iku dhe erdhi shpejt, por nuk ngurren të flasë



Jeton Selimi

Guexh: Klane te Skënderbeu, vendësit ishin kundër të huajve

Deklaron se prishi kontratën për mungesën e pagesave

Arno Guexh është një emër, i cili do të harrohet shpejt në Korçë. Mesfushori francez u afrua në merkaton e verës nga klubi korçar, i cili po bënte gati një projekt me emra të rinj dhe ai shihej si një lojtar me perspektivë. Por, gjërat nuk shkuan siç prisnin palët dhe në 12 ndeshje në kampionat e 2 në Kupë, ai mori rrallëherë vlerësime pozitive. Lamtumira e tij në janar dukej e pashmangshme dhe ashtu ndodhi sapo korçarët siguruan zëvendësues në ditët e fundit të merkatos. Por futbollisti francez duket se nuk do ta kujtojë mirë këtë periudhë në Shqipëri, pasi në një intervistë të dhënë së fundmi ka shpërthyer në akuza kundër klubit korçar. Ai e etiketon në rënie klubin, me probleme financiare, ndërsa akuzon lojtarët shqiptarë se ishin kundër futbollistëve të huaj, duke ua vënë fajin për gjithçka. "Një klub shqiptar, KF Skënderbeu, erdhi dhe më kërkoi nga Zirka në Ukrainë. Herën e parë unë e refuzova. Pastaj ata erdhën për herë të dytë më kërkuan, pasi isha futbollist i lirë. Më thanë që



Skënderbeu është klubi i parë në Shqipëri, kishin shumë pjesëmarrje në Ligën e Europës. Fakti që ata më kërkuan disa herë më përleu, ndaj u nisa drejt

kësaj aventure. Ishte fundi i merkatos dhe më duhej të gjeja një klub. Firmosa, por në fund gjërat nuk shkuan siç desha", kujton fillimisht lojtari 21-vjeçar, i cili pohon se

pas mbërritjes në Shqipëri, ka gjetur një atmosferë ndryshe, me Skënderbeun që nuk ishte më aq solid sa ia kishin përshkruar edhe për shkak të dënimit të UEFA-s. "Unë isha

6

MUAJ
Qëndroi Arno Guexh në Korçë, ku u aktivizua në 12 ndeshje në kampionat dhe 2 në Kupën e Shqipërisë.

keqe, në rënie, mbi të gjitha sa u përket rezultateve. Njohta të njëjtin problem si në Ukrainë, me vonesa pagesash. Unë prisha kontratën, pasi kisha probleme në klub. Nuk jam një njeri që hedh m... mbi të tjerët, por nuk e kuptoj pse lojtarët vendës ishin kaq shumë kundër të huajve! Nuk e di nëse kjo ndodhte se mos i zija vendin, por ishte situatë shumë e veçantë. Kur gjërat nuk shkonin siç duhej, ishte faji ynë. Një ditë, menaxheri i cili më propozoi Skënderbeun, më telefonoi pas ndeshjes dhe më tha që nuk e kuptonte pse lojtarët nuk më jepnin pasime në fushë... Na vunë shklopinj mes rrotave dhe kur nuk je pastaj i preferuari i trajnerit, gjërat komplikohen", theksoi Guexh në këtë intervistë të tij.

në dijeni të 2-3 gjërave para se të vija, por nuk ishin asgjë në krahasim me çfarë gjeta aty. Kam folur me disa lojtarë që kanë luajtur shumë sezona aty dhe më kanë treguar se klubi është në situatë të

ZHVILLIMET

Milani i kërkon Gatzos të mos jetë i... sinqertë

Gjatë gjithë ditës së djeshme, të gjitha lajmet në Itali kanë bërë me dije se Gatzos do të konfirmohet deri në fund të sezonit në stolin e Milanit. Por, sipas asaj që raporton "Sky", trajneri kuqezi është parë të hyjë në selinë e klubit, ku janë të pranishëm drejtuesit e Milanit. Gazidis, Maldini, Leonardo dhe presidenti Skaloni janë aty dhe presin Gatzos që të diskutojnë shumë për katër javët e mbetura të Serisë A dhe objektivin Champions. Gjatë kësaj mbledhjeje, drejtuesit i kanë kërkuar Gatzos që përpara mediave të gënjëjë dhe mos të shfaqë mërzinë. Ai duhet të mos tolerojë më askënd dhe të nisë t'u tërheqë veshin futbollistëve. Sipas drejtuesve, sinqeriteti i trajnerit po sillte një mosbesim të madh te grupi, që reflektohej në dhomat e zhveshjes dhe në fushën e lojës.



SPANJOLLI NUK LËVIZ

Guardiola bën gati Sitin e sezonit të ri

Pep Guardiola duket se edhe vitin tjetër do të vazhdojë të drejtojë Manchester Sitin. Kjo, sepse ai që tani ka nisur të bëjë planet për sezonin e ardhshëm. Këtë e bën të ditur "Daily Star", sipas të cillës palët kanë nisur të programojnë largimet dhe afrimet gjatë verës. Guardiola duket se nuk beson më tek Otamendi dhe Danilo, të cilët nuk po gjejnë shumë minuta. Për argjentinasiin ka oferta nga Juventus, Uest Hemi dhe Ul-vërhemptoni. 30 milionë euro mjaftojnë për të dhe Siti do ta shiste. Edhe Danilo do të largohet në verë dhe nuk ka ende oferta zyrtare nga klube, por së shpejti pritet që dhe ai të kërkohet.




PARASHIKIMET

Zbulohen kuotat për favoritët e Championsit

Barcelona-Liverpul dhe Tottenham-Ajaks janë dy çiftet gjysmëfinaliste të Champions League. Analistët e "Snai" kanë bërë parashikimet e tyre në lidhje me këto katër skuadra, duke e konsideruar Barcelonën favorite për kalimin në finale. Katalanasit kuotohen me koeficientin 1.65 për kualifikimin, ndërsa Liverpuli me koeficientin 2.15. Ndeshja e parë luhet të mërkurën në "Camp Nou", ku skuadra e trajnerit Valverde nuk humb prej vitit 2013 në Champions League. Për këtë ndeshje, fitorja e Barcelonës vlerësohet me 1.87, barazimi 3.70 dhe fitorja e skuadrës së Klop 4. Parashikimi është më i ekuilibruar për gjysmëfinalen tjetër Tottenham-Ajaks, që luhet nesër në "Wembley". Për këtë sfidë, fitorja e ekipit anglez ka koeficientin 2.50, barazimi 3.35 dhe fitorja e holandezëve 2.85. Për kualifikimin duhet thënë se është Ajaksi në avantazh të lehtë. Kualifikimi i tij kuotohet me 1.8, ndërsa kualifikimi i Tottenhamit me 1.95.

Fjalëkryqi (1)




- HORIZONTAL**
- Bëjnë arte me re.
 - Krijoi Arsene Lupin (inic).
 - Janë forma.
 - Në hyrje të plazhit.
 - Kapen të parat.
 - Janë ufo.
 - Mbahren nga ata që i thyejnë.
 - Initiallet e Mascagni-t.
 - Në krye të trupave.
 - Eshtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
 - Pak hemorrhagji.
 - U shkrua nga Jack London.
 - Institucione Ndërkombëtare Europiane.
 - Scarlet e Bashkë me erën.
 - Janë tituj në ekran.
 - Eric aktor.
 - Kështu e ka syrin vigjilent
 - Janë nofka.
 - Një provë... inteligjence.

- Mund të jenë me sahat.
 - Një pjesë e naivitetit.
 - Pak imagjinatë.
 - Pikat pa kufij
 - Fillojnë aksionin.
 - Kërkohej nga poetët.
 - Nota e diapazonit.
 - I prin kolonës.
 - Eshtë filozofie morali.
 - Ulet në dhomën e lartë.
- VERTIKAL**
- Malet pa kufij.
 - Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
 - Initiallet e Altman.
 - Një sportist që arrin majat
 - Courier ish-kampion i tenisit.
 - Fillojnë testin.
 - Mund të jetë parabolike.
 - Bje me ballë.
 - Camera, ish-kampion i rinqut.
 - Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
 - I kanë rënëjt në tokë.
 - Eshtë pushkë.
 - Brown i Kodi i Da Vinci-t.
 - Takim Brezash Durrës.
 - Ishte lumi i Elizit
 - Eshtë kardinal.
 - Mbyllin një krah.
 - Artikull anglez.
 - Mbyllin fushatat.
 - Partia pa ara.
 - Zola që shkroi Nana
 - Nganjëherë duhen vënë mbi i.
 - Një fjalë kastle
 - Initiallet e Mann shkrimtar.
 - Maiden që këndojnë.
 - Ai i shtatë është kinemaja.
 - Fillojnë arsyetimin.
 - Eshtë nënë e Tironës.
 - Eshtë shahu i fundit.
 - Initiallet e Klee piktor.
 - Dy asa.
 - Mbarojnë fare


Fjalëkryqi (2)

- HORIZONTAL:**
- Patricia këngëtare.
 - I vocërr ai i Migjenit
 - Hari sptune.
 - Qyteti i Robespierre.
 - Phineas i famshëm i cirkut.
 - Pak latinisht.
 - Incilet e Banderas.
 - Janë tek në rrota.
 - Pak efikasitet.
 - Eshtë shkolla fillore.
 - Arrihet duke aderuar
 - Pak iniciativë.
 - Një... art i Don Judd.
 - U kompozua nga Rachmaninov.
 - Diku në qendër.
 - Një është për të lidhur.
 - Jepet për hartim.
 - Sergej, poet i famshëm rus.
 - Veru pa kufij.



- Mbyllin një tender.
 - Një pjesë analogjisë.
 - Mjeku pa ju.
 - Nisin nga kreu.
 - Një racë kombi.
 - Një rapper i famshëm.
 - Një pikë... vaji.
 - Në fund majtas.
 - Ndizen me një çelës.
 - Emri i Delon
 - Janë të dërguar specialë
- VERETIKAL**
- Eshtë edhe ai i sheqerit.
 - Diku në qendër.
 - Një është për të lidhur.
 - Sapo fillojnë.
 - Qendër në Kubë.
 - Eshtë pluhuri si Dash.
 - Eshtë e hollë dhe therëse.
 - Fillojnë muzikën.
 - Një kontinent i ri.
 - Eshtë për medaljen e parë.
 - Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj perseve.
 - Provinca e boerëve.
 - Eshtë qyteti i njëmbinjë ditëve.
 - Eshtë dukuria.
 - Eshtë hidrokarbur.
 - Griffith aktore.
 - Qe perëndesha e fitores.
 - Mbeten në fund.
 - Tregon gminin.
 - Këndohet në opera.
 - Para Fe në New Mexico.
 - Eshtë princ arab.
 - Tony që këndon Quando, quando, quando.
 - Bën mëza.
 - Pak tolerante.
 - Modem pa zë.
 - Pak marramendëse.
 - Mbyllin një dyqan.
 - Fillojnë teorikisht.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

1	5	7	4		2
	7	1			
6		9		2	4
		5		1	
					7
	5		9		8
	6			9	
	4				
9			2		8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	4	5	2	9	6	3	1	7
9	1	6	7	3	4	8	2	5
7	2	3	5	8	1	9	4	6
1	9	7	3	4	5	2	6	8
2	3	8	1	6	7	5	9	4
5	6	4	8	2	9	7	3	1
3	5	9	4	1	8	6	7	2
4	8	2	6	7	3	1	5	9
6	7	1	9	5	2	4	8	3

*Argëtim
filozofik*

- Nuk me vjen inat që më gënjën, por më vjen inatë përse mendoni që besoj në ju.

- Më mirë është të meritosh e mos të fitosh, sesa të fitosh e të mos meritosh.

- Asnjëherë mos debato me një budalla. Një tjetër që mund të jetë duke shikuar, nuk do të dijë të bëjë diferencën.



*Thënie të
mencëra*

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19		
6	4	1	3		11			3	T	R	18	14	P
13				3	2	4	3	2	4	5	3		
	7	2	9	5	4	6	5	4	5	3			18
13	5	11	6	9	5	10	3	2	3		14	4	
19				3	2	16	1	4		2	3	2	
	7	4	6	14	5						1	11	5
8	11			6	11	14							
	3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2	
18	8			4		5	7	6	14	6		3	5
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	5	3	
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3	6	

- Një skllav ëndërron lirinë, një njeri i lirë ëndërron pasurinë, një i pasur ëndërron fuqinë dhe një fuqishëm ëndërron lirinë..
- Nuk ka trëndafilja pa gjemba, por ka gjemba pa trëndafilja. Arthur Schopenhauer
- Nëse nuk tregon të vërteten për veten nuk mund të tregosh dot as për të tjerët.

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

H	E	S	A	P	E	T	I	P	A	R	C		
E	M	I	R	A	T	E	A	R	A	B	E	T	
L	I	K	E	R	B	E	T	O	N	E	T		
E	L	I	S	A	D	R	I	V	A	L	E	T	
N	R	B	U	R	I	M	E	T	J	A	T		
M	A	R	O	K	E	N	E	O	D	A	T		
F	U	L	L	A	N	I	E	M	E	A	T		
P	A	R	A	A	T	O	M	I	K	E	T		
A	N	S	T	E	R	E	O	L	I	T	A		
P	A	R	A	I	S	D	E	M	A	R	I	A	
A	N	A	I	S	D	E	P	R	E	S	I	O	N
S	A	R	D	O	U	D	E	T	I	T	A	T	

FJALËKRYQI (2)

P	A	R	A	G	R	A	F	I	I	V	A	N
I	R	O	N	I	A	G	O	S	E	R	A	T
R	A	B	A	T	B	A	N	A	R	A	T	A
A	M	E	T	T	A	N	V	R	I	M	A	T
T	I	T	R	E	L	E	M	A	K	U	L	L
V	S	K	A	N	A	R	I	N	A	E	N	A
A	L	V	A	T	I	K	A	N	I	E	N	A
J	O	E	T	N	E	T	E	M	A	T	A	T
R	I	M	A	T	R	A	D	E	T	I	T	A
A	R	I	A	N	A	R	U	N	I	K	A	T
T	A	L	E	N	T	M	A	U	R	I	C	E

